# GAZETA SHQIPTARE




Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXVI - Nr. 7838 E hënë 1 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)




Opinioni i Ditës

Nga GERON KAMBERI

## 10 vjet Marrëveshje Stabilizim-Asocimi-MAS: Të ecësh drejt BE-së



Duke qenë se koha rrjedh, pavarësisht problematikave që mbart Shqipëria në tranzicionin e saj të gjatë e të lodhshëm, më 1 prill 2019 mbushen 10 vjet kur hyri ...

Vijon në faqet 20-21

Dje në "Deutsche Welle"

Nga HILAL KOJLU

## Zgjedhje në Turqi, vjelje votash me dënimin me vdekje?



Nga përpjekja për puç në vitin 2016, kthimi i dënimit me vdekje debatohet shpesh në Turqi. Para zgjedhjeve lokale të dielën (31.03) presidenti Erdogan ...

Vijon në faqen 21





Shkodranët të terrorizuar, policia 'blindon' qytetin

## Vrasja e Bilalëve, detajet e përcjelljes. Ish-boksieri lejohet nga burgu për varrimin

Zbulohen detaje të reja mbi ngjarjen e së shtunës, Astriti tentoi të vetëmbrohej

Detaje të reja janë zbuluar pas vrasjes së dyfishtë në Shkodër të vëllezërve Bilali. Njëri prej viktimave, Astrit Bilali, në momentin kur është qëlluar me armë nga autorët ka nxjerrë një pistoletë që e mbante me vete. Pasi është plagosur, Astrit Bilali ka nxjerrë pistoletën dhe ka qëlluar disa herë, por e ka pasur të pamundur që të shënjestrojë autorët, pasi ...

Në faqet 2-3

"NGA INDEKSIMI VJETOR ME 2.8 PER QIND DO TE PREKEN 740 MIJE TE MOSHUAR"

# EKSPERTI: SA DO TE RRITEN PENSIONET E KUSH PERFITON

Klodian Muço: Sa do të jetë masa e një pensioni minimal dhe maksimal.
ISSH: Si do të ndryshojë mosha e daljes në pension për burrat dhe gratë





*(Në foto)* Eksperti i ekonomisë, Klodian Muço. Pensionistë

Në faqet 6-7

PADIA NE GJYKATE

## Ish-deputetët e PD dhe LSI kërkojnë pagat dhe përfitimet që u janë mbajtur

Në faqen 5

KUNDERPERGJIGJJA

## Me Dakon në krahë, Rama akuza Bashkisë Kavajë: Ju ndërtoni pallate në rërë

Në faqen 4

NGJARJA E RENDE

## Vranë shqiptarin Albert Bako në burgun grek, dalin pamjet e tmerrshme

Në faqen 18

HISTORIA E "KANGUR"

## Testi ndërkombëtar i matematikës, 6500 nxënës në pritje të rezultateve

Në faqen 8

LISTA ME PERFITUESIT




## Ndërtuan pa leje, ja 600 pronarët që u miratohet e drejta mbi truallin

Në faqet 9-12

Ylli Merja: Si të trajtoni infeksionet e rënda të veshkave brenda 2 muajsh

# Lorela Garuli: Si t'i njihni fëmijët përmes pikturave

*Psikologia jep shembuj konkretë që lidhen me gjendjen e të vegjëlve*

NGA VOLTIZA DURO

Vizatimi si një instrument matës është i vlefshëm në çdo moshë, por përdorimi i tij në fëmijërinë e hershme është një nga instrumentet më të përdorura, për arsyen e thjeshtë se është një nga aktivitetet kryesore të kësaj



grupmoshe krahas lojës. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", psikologia Lorela Garuli tregon mënyrat që të mund të kuptoni fëmijën nëpërmjet vizatimeve që ai realizon. Ajo sqaron me shembuj konkretë ...

Suplement

VRASJA NË SHKODËR
HETIMET

Zbulohen detaje të reja mbi ngjarjen e së shtunës, ja si ndodhi

# Vrasja e vëllezërve Bilali, Astriti tentoi të vetëmbrohej

## *Qëlloi disa herë ndaj autorëve, por nuk i shënjestroi*





I ekzekutuari Brahim Bilali



I ekzekutuari Astrit Bilali

**SHKODËR**

Detaje të reja janë zbuluar pas vrasjes së dyfishtë në Shkodër të vëllezërve Bilali. Njëri prej viktimave, Astrit Bilali, në momentin kur është qëlluar me armë nga autorët ka nxjerrë një pistoletë që e mbante me vete. Pasi është plagosur, Astrit Bilali ka nxjerrë pistoletën dhe ka qëlluar disa herë, por e ka pasur të pamundur që të shënjestrojë autorët, pasi ai ishte plagosur, por ka shtënë në mënyre instiktive. Nga ana tjetër, policia vendore e Shkodrës ka shoqëruar të paktën 30 persona për ngjarjen e një dite më parë, të cilët janë marrë në pyetje, por asnjë prej dëshmive nuk është e vlefshme për të çuar tek zbulimi i autorëve. Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, që ishte në Shkodër ka kërkuar me ngulm që policia të zbulojë këtë vrasje të dyfishtë si dhe lidhjen me ngjarjet e kaluara kriminale të ndodhura në Shkodër. Vëllezërit Astrit dhe Brahim Bilali, konkretisht 59 dhe 61 vjeç u ekzekutuan mëngjesin e së shtunës rreth orës 09:45 në lagjen "Guerile", në vendin e quajtur "Zooteknika". Autorët që dyshohet se lëviznin me një "Benz", dy persona të maskuar, kanë qëlluar me breshëri mbi dy vëllezërit, shumë pranë banesës së këtyre të fundit. Besohet se viktimat kanë qenë duke shkuar tek e motra, që jetonte shumë pranë tyre. Në ato momente dy personat janë afruar me mjetin tip "Benz" dhe i kanë qëlluar me breshëri automatiku për t'u larguar më pas me shpejtësi. Pista kryesore ku po heton policia ka lidhje me ngjarje të tjera kriminale të ndodhura në Shkodër. Automjeti i përdorur nga autorët është gjetur duke u djegur në një rrugicë në brendësi të lagjes ku ka ndodhur ngjarja. Ndërkohë një prej viktimave, Astrit Bilali është babai i Asmer Bilalit, ish-kampioni i boksit, që u arrestua si pjesë e grupit "Bajri" në ndërhyrjen e datës 6 shtator në Shkodër dhe që dyshohet se ishte edhe shënjestra e atentatit ku u vra Ferracaku hipur mbi kalë. Nuk dihet nëse vrasja e të atit dhe xhaxhait të tij ka lidhje me Asmerin, që tashmë qëndron pas hekurave si pjesë e grupit "Bajri".

### Vrasësi me pagesë është nga Gramshi, ja ç'ju gjet

## Policia parandalon një vrasje në Lezhë, kapen porositësi dhe autori



**LEZHË** - Policia e Lezhës ka parandaluar një vrasje duke arrestuar si porositësin, ashtu edhe autorin që do kryente krimin. Ndonëse nuk jep emra, policia thotë se falë informacioneve të marra në rrugë operative ka kapur vrasësin në tentativë, një adoleshent nga Gramshi, i cili ishte porositur për vrasjen e një shtetasi nga fshati Rrilë i Lezhës. "Pas një pune të mirorganizuar dhe ndërhyrjes së guximshme të agjentëve të policisë kriminale në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, u bë e mundur kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasve S. H., 18 vjeç, lindur në Gramsh dhe banues në Elbasan dhe M. K., 43 vjeç, me banim në fshatin Shënkoll të Njësisë Administrative Shënkoll", shkruhet në komunikatë. "Shtetasi S.H., i porositur nga shtetasi M.K., më datë 30.03.2019, gjatë orëve të vona të natës do të qëllonte me armë zjarri në drejtim të një shtetasi me banim në fshatin Rrile të Bashkisë Lezhë, ku për arsye hetimi nuk bëjmë me dije gjeneralitetet e tij dhe më pas do t'i merrte automjetin në oborrin e banesës së tij për t'u larguar. Në cilësinë e provës materiale janë sekuestruar një armë zjarri automatik kallashnikov, një karikator me 30 copë fishekë, një çantë me ngjyrë të zezë ku brenda saj kishte 45 fishekë model 56, një kapuç ngjyrë e zezë, një palë doreza ngjyrë e zezë, dy aparate telefonash celular. Materialet procedurale do t'i kalojnë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprën penale 'Vrasje me paramendim në bashkëpunim e mbetur në tentativë", në ngarkim të shtetasit M. K., ndërsa 'Vrasje me paramendim në bashkëpunim e mbetur në tentativë', 'Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve'", në ngarkim të shtetasit S.H..

SHKURT

### Policia kap 44-vjeçarin që lëvizte me armë, pas denoncimit

Policia e Tiranës ka vënë në pranga një 44-vjeçar për armëmbajtje pa leje pas denoncimit të qytetarëve. Sipas të dhënave zyrtare, në numrin e emergjencave 112 qytetarët kanë njoftuar se në zonën e Kombinatit një shtetas lëvizte me armë. Shërbimet e Policisë të komisariatit nr.6 kanë bërë krehjen e zonës dhe në rrugën "Konferenca e Pezës" kanë konstatuar shtetasin, i cili përkonte me përshkimin e dhënë. Gjatë kontrollit fizik të ushtruar, shërbimet e policisë i gjetën një armë zjarri pistoletë. Në kushtet e flagrancës u bë arrestimi i shtetasit G. T., 44 vjeç, banues në Tiranë (i dënuar më parë për veprat penale "Vjedhje" dhe "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve dhe municionit luftarak").

### Shpërthimi në Vlorë, policia: E ka vënë i biri i pronarit

**VLORË** - Policia e Vlorës ka mundur të zbardhë ngjarjen e ndodhur të shtunën në këtë qytet, ku shpërtheu një sasi lënde eksplozive në oborrin e një banese. Policia ka identifikuar dhe ka shpallur në kërkim autorin, i biri i pronarit të banesës ku ndodhi shpërthimi, ndërsa thotë se ngjarja ka si motiv konfliktin e pronësisë. "Nga Policia e Vlorës është bërë e mundur zbardhja e ngjarjes, motivit të saj, si dhe identifikimi e shpallja në kërkim e autorit të dyshuar. Nga tërësia e veprimeve hetimore të kryera ka rezultuar se autor i dyshuar i ngjarjes të jetë i biri i shtetasit F. O., (shtetasi E. O.,). Ngjarja dyshohet se ka ndodhur për motive pronësie dhe konflikteve të vazhdueshme midis tyre", thuhet në komunikatën e policisë.

**SHPALLJE ANKANDI**

**Zyra Permbarimore "E.G Bailiff Service"** me përmbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më date 25.04.2019 ora 8°° - 16°° në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III-të për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Apartament me sipëfaqe totale 86.35 m², me numër pasurie 2/139/ND+1-13, volumi 71, faqe 142, zona kadastrale 8518, me adresë Lagja 13, Plazh, Hyrja 1, Ap.13 Durrës, në pronësi të Z.Çlirim Sejfulla Xhafa dhe Znj.Bardha Xhemal Xhafa me vlerë fillestare në ankand 20,454.84 (Njëzet mijë e katërqind e pesëdhjet e katër pikë tetëdhjet e katër) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Dossier:** Iv Kaloçi, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**, *Marketingu*:** Cel:0688087823***-email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**

Shkodra nën terror, forca të shumta policie rrethojnë qytetin

# Përcillen për në banesën e fundit 2 vëllezërit, Asmeri në varrim

## *Shoqërohen 30 persona për vrasjen e Astrit dhe Brahim Bilalit*




Shkodra po kalon një situatë të pazakontë muajt e fundit. Me 7 të vrarë dhe asnjë të arrestuar, frikën kanë nisur ta ndjejnë edhe qytetarët e thjeshtë. Dhe e diela i shoqëroi shkodranët me një ndjejnë terrori. Forca të shumta policie blinduan qytetin veriperëndimor, ndërsa do zhvillohej ceremonia mortore e dy vëllezërve të vrarë të shtunën, Astrit dhe Brahim Bilalit. Ndërkaq, Asmer Bilali, djali i Astrit Bilalit, i cili njihet si një nga anëtarët e grupit "Bajri", u lejua nga burgu për të marrë pjesë në ceremoninë mortore. Asmer Bilali është ish-kampioni i boksit, që u arrestua si pjesë e grupit "Bajri" në ndërhyrjen e datës 6 shtator në Shkodër dhe që dyshohet se ishte edhe shënjestra e atentatit ku u vra Ferracaku hipur mbi kalë. Ai njihet edhe si person me precedentë penalë të mëparshëm në policinë e Shkodrës, si dhe është i dyshuari kryesor për plagosjen e Hermes Beqirit në një nga lokalet e qytetit. Për ngjarjen e ndodhur në vitin 2017, Asmer Bilali u arrestua në fshatin Grudë, ku ishte larguar me motorin e tij për t'ju fshehur policisë. Atij iu gjet edhe një armë tip pistoletë, që mendohet se është përdorur për kryerjen e krimit. Nuk dihet nëse vrasja e të atit dhe xhaxhait të tij ka lidhje me Asmerin, që tashëm qëndron pas hekurave si pjesë e grupit famëkeq të Shkodrës. Asmeri u shoqërua gjatë funeralit nga 3 furgonë policie, ndërsa të tjerë qarkullonin në qytet, duke kaluar në sitë çdo rrugë e ngritur postblloqe të shumta për evidentimin e çdo rasti të dyshimtë. Për vrasjen e dy vëllezërve Bilali policia ka shoqëruar rreth 30 persona dhe ka sekuestruar pamjet e kamerave të sigurisë për të gjetur ndonjë provë që mund të ndihmojë për zbardhjen e krimit të dyfishtë. Grupi hetimor po vlerëson çdo element të mundshëm, ndërsa në pyetje do të merren edhe të afërmit e viktimave.

**FUNERALI**

Dy vëllezërit Bilali u përcollën për në banesën e fundit në orën 15:00, ndërsa furgonë të shumtë policie rrethuan ceremoninë dhe qytetin e Shkodrës, i cili së fundmi po jeton nën terror. Në varrim mori pjesë edhe djali i 59-vjeçarit Astrit Bilali, Asmeri, ish-boksier i cili ndodhet i burgosur te 313-ta në Tiranë.




**SHENJESTRA E ATENTATIT**

Asmer Bilali është ish-kampioni i boksit, që u arrestua si pjesë e grupit "Bajri" në ndërhyrjen e datës 6 shtator në Shkodër dhe që dyshohet se ishte edhe shënjestra e atentatit ku u vra Ferracaku hipur mbi kalë. Ai njihet edhe si person me precedentë penalë të mëparshëm në policinë e Shkodrës, si dhe është i dyshuari kryesor për plagosjen e Hermes Beqirit në një nga lokalet e qytetit.

## Gjyshi i Asmer Bilalit: Lejojeni nipin të rrijë dy ditë në shtëpi

Fahri Vejuka, gjyshi i Asmer Bilalit, ishboksierit që ndodhet në burg i arrestuar si pjesë e grupit "Bajri", ka një lutje për shtetin. Ndërsa sot përcjell dhëndrin për në banesën e fundit të vëllain e tij, Vejuka kërkon që Asmeri, nipi i tij, të qëndrojë për dy ditë në shtëpi për të pritur njerëzit. I moshuari thotë se në këtë familje ka mbetur vetëm një djalë 23 vjeç, shumë i sëmurë, ndërsa nga ana tjetër pasi falënderon shtetin që e ka lejuar nipin të marrë pjesë në varrim, kërkon të shikojë këtë familje. "Shpresojmë që shteti të gjejë autorët e vrasjes, sepse është një ngjarje shumë e rëndë. Pothuajse është shuar një familje pas kësaj ngjarjeje dhe institucionet do të bëjnë detyrën e tyre për çfarë ka ndodhur. Asmer Bilali është djali i Astrit Bilalit dhe Asmeri është në burg prej disa muajsh. Ai do të jetë vetëm në varrim, por ne kërkojmë që të lihet të paktën dy ditë tek banesa e tij për të pritur njerëzit, sepse nuk ka askënd. Vëllai i tij 23 vjeç është shumë i sëmurë dhe nuk është askush tjetër. Shpresojmë që institucionet të vendosin dorën në zemër dhe të na mirëkuptojnë në kërkesën tonë. I falënderojmë që e kanë lejuar të jetë në varrim, por kërkojmë të qëndrojë pak më gjatë, të paktën dy ditë dhe normalisht me prezencën e policisë. Për të tjerat, shteti të bëjë detyrën dhe nëse ka bërë diçka, mund të dënohet, por sot i kërkojmë ta lejojnë të paktën dy ditë që të qëndrojë, sepse do dalin dy kufoma nga shtëpia jonë", tha Fahri Vejuka.



**SHKURT**

### Massafra: Disa i fusin plumbin kokës dhe nuk kërkojnë falje

Arqipeshkevi i dioqezës Shkodër-Pult Angelo Massafra ka komentuar ngjarjet e rënda të ndodhura në Shkodër, vrasjen e Ferdinand Polias dhe të dy vëllezërve Bilali dy ditë më parë. Arqipeshkevi Massafra solli historinë e një babai që kishte dy djem, ku njëri nga djemtë e braktis babain për shkak se nuk i siguron pasuri. Arqipeshkevi u shpreh se fëmijët e sotëm nuk dinë të kërkojnë falje dhe të kuptojnë gabimet e tyre, duke sjellë më pas veprime që i çojnë drejt sjelljeve negative si droga apo krimet. "Vetëm si shkak i krenarisë që kemi kur gabojmë, disa pranojnë që t'i fusin plumb kokës dhe të mos tërhiqen edhe kur e dinë se janë gabim. Kjo nuk është gjeja e duhur", - deklaroi Massafra. Po ashtu, bëri thirrje që të gjithë të mos u bëjnë keq të tjerëve dhe të falin, si e vetmja mënyrë për të shkuar pranë Zotit në parajsë. Deklaratat e arqipeshkevit Massafra u bënë në katedralen "Shën Shtjefni" për 200-vjetorin e lindjes të arbëreshit Andon Santori. Deklaratat e arqipeshkevit Massafra erdhën në të njëjtën ditë kur Shkodra përcolli për në banesën e fundit dy vëllezërit Bilali, të cilët mbetën të vrarë të shtunën pas një atentati në derën e shtëpisë.

### Vrasja e avokatit të Shullazit, policia 'blindon' Elbasanin

Në orët e para të mbrëmjes të së dielës, Elbasani është blinduar nga prania e forcave të shumta policore. Pas ngjarjeve të rënda të ndodhura në këtë qytet, raportohet që kjo është prania më e shumtë e konstatuar në këtë qytet. Në të gjitha kryqëzimet dhe akset rrugore të Elbasanit si dhe nëpër lagjet kryesore të këtij qyteti ka patrullime të forcave "Shqiponja" dhe të FNSH-së. Ndërkohë, mësohet se policia është duke kontrolluar imtësisht përdoruesit e automjeteve dhe të gjithë personat me precedentë penalë. Ka pasur kontrolle të befasishme në biznese të ndryshme dhe në banesa. Burimet zyrtare janë të rezervuara në dhënien e informacioneve, por burime konfindenciale konfirmuan se policia është duke ushtruar detyrat e saj për sigurimin e rendit dhe qetësisë publike, si dhe për parandalimin e zbulimin e aktivitetit kriminal që ushtrojnë persona të ndryshëm.

**Shoqeria permbarimore JUSTITIA**

Shoqeria permbarimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e DYTE, për shitjen e pasurisë së paluajtshme per te cilen ka vene hipoteke NBG BANK/ABI BANK, me këto të dhëna:
Nr. 1/387-N1, ZK. 8562, VOL 30, FAQ. 91 e llojit njësi me sip. 109 m2 ndodhur në adresën Rruga "Fuat Babani", Korçë ne pronesi te Pandeli Bonja.
Çmimi me të cilin fillon ankandi është në vlerën 48.832 EUR( dyzetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy ) EUR
Nr. 1/387-N3, ZK. 8562, VOL 30, FAQ. 93 e llojit njësi me sip. 89.2 m2 ndodhur në adresën Rruga "Fuat Babani", Korçë,ne pronesi te Pandeli Bonja.
Çmimi me të cilin fillon ankandi është në vlerën 39.961 EUR(tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një) EUR.
Ankandi zhvillohet në datën 29.04.19, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor, me Adrese: Bulevardi"Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

ZGJEDHJET
AKUZAT

## Bardhi: Ndërtimi pa asnjë kriter, filozofi e qeverisjes lokale të Ramës

# Me Dakon në krahë, Rama akuza Bashkisë Kavajë: Ndërton në rërë

## Rama i bëri akuzat gjatë vizitës në një shkollë në Golem

Gjatë vizitës së tij në qarkun e Durrësit, kryeministri Edi Rama pas takimit "Bashkia që duam", i shoqëruar edhe nga kryebashkiaku Vangjush Dako, vizitoi shkollën "Charles Telford Erikson" në Golem të Kavajë, e cila është një shkollat më të vjetra të profilit bujqësor në Shqipëri. Këtë vit, kjo shkollë u ndërtua krejtësisht e re, së bashku me bazën prodhuese, me një investim të buxhetit të shtetit prej 250 milionë lekësh. Aktualisht në këtë shkollë mësojnë 162 nxënës në 3 drejtime mësimore, Agrobiznes, Veterinari dhe Ekonomi. Megjithëse shkolla aktualisht nuk ka një sipërfaqe të mjaftueshme për bazën e saj prodhuese, me investimin e ri, ajo ofron një bazë eksperimentale model edhe për shkollat e tjera profesionale. Sipas njoftimit të Kryeministrisë, konviktet e kësaj shkolle të administruara nga bashkia mbeten prej vitesh problematika më e madhe, ku shpesh gjendja e tyre e mjerueshme bëhet pengesë për prindërit që duan të arsimojnë fëmijët e tyre në profilet që shkolla ofron.



**RAMA**
"Të bëhet një projekt për konviktet dhe bëjmë konviktin si pjesë e shkollës e t'ia lëmë shkollës, ose të gjejmë një formë administrimi, se bashkia këtu nuk ka ndërmend të bëjë as konvikte, as shkolla. Bashkia këtu ndërton pallate në rërë akoma sot e gjithë ditën dhe s'kanë faj, përderisa sot akoma s'ka ardhur dora e prokurorisë".

**AKUZAT**

Pasi dëgjoi shqetësimin e mësuesve lidhur me konviktet, kryeministri kërkoi prej tyre hartimin e një projekti dhe premtoi mbështetje për zgjidhjen më të mirë të mundshme. Ndërkohë, nisur nga kjo situatë ai lëshoi akuza në drejtim të Bashkisë së Kavajës, që drejtohet nga Isa Sakja, i zgjedhur nga Partia Demokratike. Ai e akuzoi atë se lejon ndërtimin e pallateve në rënë. "Të bëhet një projekt për konviktet dhe bëjmë konviktin si pjesë e shkollës dhe t'ia lëmë shkollës, ose të gjejmë një formë administrimi, se bashkia këtu nuk ka ndërmend të bëjë as konvikte, as shkolla. Bashkia këtu ndërton pallate në rërë, akoma sot e gjithë ditën dhe s'kanë faj, përderisa sot akoma s'ka ardhur dora e prokurorisë. Ndërkohë, bëni projektin ose në qoftë se e keni çuar në bashki, ta merrni mbrapsht. Ta bashkojmë shkollën me konviktin dhe të gjithë këtë ta bëjmë si kampus për nxënësit dhe pastaj të shikojmë edhe projektin e shkollës 9-vjeçare Golem", - u shpreh kryeministri.

**BARDHI**

Ndaj këtyre akuzave, ka reaguar dje numri 2 i Partisë Demokratike, Gazmend Bardhi, i cili nëpërmjet një komenti në rrjetet sociale, ndërsa i ka kthyer përgjigje Ramës, ka theksuar se ai përfaqëson modelin më të keq të qeverisjes vendore dhe asaj qendrore. "Ai që ndërtimin e pallateve, kudo dhe pa asnjë kriter e bëri filozofi të qeverisjes së tij lokale, ai që përmes pallateve që mbolli kudo dhe me haraçin e tyre mori partinë, sot sulmoi me shpifje të ulëta Bashkinë e Kavajës. Me modelin tjetër të qeverisjes lokale në krah, me Vangjush Dakon që për pallate nuk kursen as trashëgiminë e qytetit, në vend të ofrimit të zgjidhjes për mijëra të papunët në Kavajë, zgjodhi kërcënimin dhe shantazhin ndaj kryetarit të Bashkisë Kavajë", - tha Bardhi. Ai ftoi gjithashtu prokurorinë që të hetojë qeverisjen lokale të socialistëve në Durrës, Tiranë e Elbasan. "Meqë jemi te prokuroria, bëju thirrje të kalojnë njëherë nga Durrësi i Gjushit, pastaj nga kullat e parave të pista në Tiranë, pastaj tek Qazimi në Elbasan dhe me radhë te të gjithë modelet e tua të qeverisjes kriminale lokale. Koha ku ti urdhëroje se kush bandë do marrë lejen e radhës së ndërtimit në Kavajë ka përfunduar! E di që je i zhgënjyer për këtë. Mësohu, së shpejti këtë mundësi s'do ta kesh në të gjithë Shqipërinë", - shtoi Bardhi.

## Reagon kryetari i Bashkisë së Kavajës: Zhbëmë monopolin e rilindjes

Kryetari i Bashkisë së Kavajës, Isa Sakja, u është përgjigjur dje deklaratave të kryeministrit Edi Rama, të bëra gjatë vizitës së tij në Golem. Përmes një postimi në "Facebook", Sakja shprehet se nën drejtimin e demokratëve, në Bashkinë e Kavajës është shembur monopoli i ndërtimit, drejtuar nga rilindja. "Kryeministri Rama përdori një vizitë inkonjito në Golem, duke hedhur fjalë në tym, siç e ka në stilin e tij të konsumuar retorik, për të nxitur një sulm politik ndaj meje. Zoti Rama, që ndërtimi është një valvule shkarkuese për punësim, këtë duhet ta dish! Nën



drejtimin e demokratëve, në Bashkinë e Kavajës është shembur monopoli i ndërtimit 6-vjeçar të klanit rilindas, kjo është e vërteta. Kjo e ka shqetësuar klikën e rilindasve në qytet, e cila uzurpoi edhe rërën, edhe zhavorrin, edhe mistritë e muratorëve punëtorë në Kavajë për t'ia dhënë të gjitha vetëm një firme. Kjo nuk ndodh më!", - shkroi Sakja. Ai ndër të tjera shprehet se Rama ka frikë nga Kavaja dhe protestat, ndaj edhe e sulmon.



SHKURT

## Kryemadhi: Zgjedhjet e parakohshme në prag, ndezim 'motorët' e fushatës

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi dhe ish-deputeti Vangjel Tavo zhvilluan dje një takim organizativ me strukturat e LSI-së në Tepelenë. Në ketë takim u zgjodh dhe kryetari i LSI në Tepelenë, ekonomisti Sefer Kanushi. Gjatë fjalës së saj, kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi tha se zgjedhjet e parakohshme janë afër dhe se tashmë duhet të ndizen motorët e fushatës. "Zgjedhjet e parakohshme janë afër, ndaj ndizni 'motorët' e fushatës", - tha Kryemadhi gjatë këtij takimi. Duke folur për situatën aktuale, kryetarja e LSI-së, Kryemadhi, deklaroi se gjendja ekonomike e vendit është e mjerë, pasi taksat rriten çdo ditë, ndërsa të ardhurat për familjet shqiptare ulen. "Gjendja ekonomike e vendit është e mjerë. Taksat rriten, ndërkohë që të ardhurat për familjet shqiptare ulen. Duhet të ndalojmë eksodin e shqiptarëve. Rinia duhet të gjenerojë energji në Shqipëri, jo të marrë rrugët e emigrimit. Duhet të punojmë që shqiptarët ta bëjnë Shqipërinë shtëpinë e tyre. Papunësia ka ardhur për shkak të paaftësisë dhe korrupsionit qeveritar. LSI-ja është partia e fjalës së mbajtur, forcën reale e ka te njerëzit, jo tek emrat e përveçëm", - u shpreh Kryemadhi. Gjithashtu, kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi ishte dje edhe në Seman të Fierit, ku vizitoi një fermë të mbarështimit të bagëtive. Ajo u njoh nga afër me problematikat e shumta që hasin sot fermerët dhe blegtorët, për shkak të mungesës së subvencioneve. Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi tha se ashtu siç kjo qeveri ka harruar të gjithë shqiptarët, ka harruar edhe blegtorët





## Të ardhurat e deputetëve, 300 mijë lekë të reja në muaj

Të ardhurat e një deputeti përbëhen nga dy zëra të veçantë, paga dhe përfitimet për shkak të statusit të deputetit. Paga bruto e një deputeti është 156770 lekë të reja, ndërsa ajo neto shkon 117880 lekë. Nga paga bruto një deputeti i zbriten 10 mijë lekë kontribut i detyrueshëm i sigurimit shoqëror, 2600 lekë kontribut i detyrueshëm i sigurimit shëndetësor, 7800 lekë kontribut suplementar dhe 19 mijë lekë tatim mbi pagën. Por kjo është vetëm pjesa e pagës, pasi të zgjedhurit tanë në Kuvendin e Shqipërisë kanë dhe një sërë përfitimesh të tjera financiare, që në total shkojnë më shumë se paga. Kështu, deputetët tanë marrin edhe gati 150 mijë lekë të reja të tjera të ardhura si përfitime nga statusi i deputetit. Më konkretisht, një deputet merr deri në 40 mijë lekë të reja si pagesë karburanti në muaj, kjo në varësi të largësisë së zonës ku është zgjedhur deputeti. Po ashtu, ai merr edhe 17 mijë lekë si rimbursim për pagesën e telefonit, merr deri 75 mijë lekë si dieta, 32 mijë lekë si honorarë për pjesëmarrjen në komisione, ndërsa një pjesë marrin rimbursim qiraje për banesë apo hotel. Pra, në total një deputet i Kuvendit të Shqipërisë arrin të përfitojë rreth 300 mijë lekë në muaj, si të ardhura nga paga dhe përfitimet për shkak të statusit të deputetit. Natyrisht nga kjo shumë zbriten apo mbahen ndalesat për çdo mungesë në komision dhe në seancë plenare.



### Ish-ligjvënësit e PD dhe LSI kërkojnë përfitimet e mbajtura

# Bojkotuan Kuvendin, ish-deputetët e opozitës padisin Ruçin për pagat

## *Sipas opozitarëve, bojkoti ishte vendimmarrje politike*

Fillimisht bojkoti dis amujor dhe tani dje gia e mandateve ka shkaktuar probleme financiare për një pjesë të ish-deputetëve të opozitës, të cilët duket se të ardhurat nga statusi i deputetit i kanë pasur burime kryesore financiare në familje. Për shkak të një vendimi politik, ata bojkotuan pjesëmarrjen në Kuvendin e Shqipërisë nga muaji korrik 2018 deri në dhjetor të 2018-ës, por pavarësisht se kishim të bënim me një vendimmarrje politike, Kuvendi u mbajti atyre pagesat për të gjitha muajt e bojkotit të veprimtarisë së tij. Ndaj, nisur nga ky veprim i administratës së Kuvendit, disa nga ish-ligjvënësit e Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim e kanë kundërshtuar mbajtjen e pagave në Gjykatën Administrative, ku kanë paditur Kuvendin dhe kanë kërkuar pagat e padhëna. Ata kanë vërshuar në dyert e gjykatës për të kërkuar lekët si deputetë për kohën kur ishin të mandatuar, por për shkak të vendimit të grupit ishin në marrëdhënie të kushtëzuar (bojkot). Në paditë e deputetëve të PD dhe të LSI ndaj Kuvendit të Shqipërisë kërkohen pagesat për 6 muaj muajt e bojkotit të tyre të parlamentit. Nga dosja rezulton se ish-deputetja Valentina Duka kërkon prej gjykatës detyrimin e Kuvendit të Shqipërisë që t'i paguajë shumën 187.090 lekë të ndaluara, sipas saj, padrejtësisht nga paga e deputeti për periudhën korrik 2018-janar 2019. Po ashtu një tjetër ish-deputet, Shezai Rrokaj, i kërkon gjykatës që Kuvendi ta paguajë në shumën 187.261 për po të njëjtën periudhë kohore. Të njëjtën gjë kërkon edhe ish-deputetja Fatbardha Kadiu, e cila pretendon të marrë 192.582 lekë. Por, këto janë pretendime vetëm për vitin 2018, pasi siç rezulton në Gjykatën Administrative janë depozituar edhe një sërë padish të tjera nga ish-deputetët e opozitës, të cilët kanë kërkuar pagesat edhe për periudhat e tjera të bojkotit të ndodhura edhe gjatë legjislaturës pararendëse. Më konkretisht, deputeti Luçiano Boçi kërkon detyrimin e Kuvendit që t'i paguajë shumën prej 319.315 lekësh, shumën 107.141 lekësh dhe shumën 187.090 lekë të ndaluara sipas tij, padrejtësisht nga paga e deputetit. Dhe për të njohur këto detyrime, ai në kërkesëpadinë e vet u referohet periudhave 01.07.2014-01.01.2015, periudhën 01.02.2017-01.06.2017 dhe për periudhën korrik 2018-janar 2019. Por në listën e deputetëve që i janë drejtuar gjykatës është edhe Gert Bogdani, Oerd Bylykbashi dhe Edi Paloka. Më konkretisht, tre deputetët demokratë kërkojnë përfitimet financiare për periudhën 01.07.2014-31.01.2015 dhe për periudhën 01.02.2017-01.06.2017, përfitime që sipas tyre, burojnë nga legjislacioni për "Statusin e deputetit" dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit. Pra, tre ish-deputetët Bogdani, Bylykbashi dhe Paloka kërkojnë përfitimet e ndalura (jo pagën) nga ana e Kuvendit për periudhat e bojkotit gjatë legjislaturës së shkuar dhe të tanishme.



**PËRFITIMET**

Në listën e deputetëve që i janë drejtuar gjykatës është edhe Gert Bogdani, Oerd Bylykbashi dhe Edi Paloka. Më konkretisht, tre deputetët demokratë kërkojnë përfitimet financiare për periudhën 01.07.2014-31.01.2015 dhe për periudhën 01.02.2017-01.06.2017, përfitime që sipas tyre, burojnë nga legjislacioni për "Statusin e deputetit" dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit.



## Dogjën mandatin, ish-deputetët i kthehen mësimdhënies në universitet

Një pjesë e ish-ligjvënësve opozitarë që lanë mandatin e deputetit vijnë nga fusha e mësimdhënies dhe botës akademike. Angazhimi në politikë bëri që ata të shkëputen nga aktiviteti i tyre i mësimdhënies në universitete dhe tashmë që kanë lënë mandatet e deputetëve janë detyruar që t'u rikthehen edhe një herë auditorëve të universiteteve. Dy prej tyre janë Valentina Duka dhe Shezai Rrokaj, të dy pedagogë në Fakultetin e Histori-Filologjisë në Universitetin e Tiranës, të cilët u janë kthyer përfundimisht dhe me kohë të plotë auditorëve, duke i kthyer shpinën një parlamenti konfliktesh. "Të them të vërtetën, ashtu si u katandis ky parlament, më mirë në auditorë. Unë isha pedagog i jashtëm më parë, tani ndihem plotësisht në lëkurën time", - tha para disa ditësh Shezai Rrokaj. "Më mirë në auditorë, mendoj se jam kthyer përfundimisht këtu për të mos e lënë më kurrë. Veten time e mendoj më frytdhënëse në ambientin akademik", - u shpreh Valentina Duka. Krahas tyre, një tjetër ish-deputet që ka kërkuar të rikthehet në botën akademike dhe të mësimdhënies është Luçiano Boçi.

# RRITJA E PENSIONEVE
## VENDIMI

Eksperti i ekonomisë: Sa do të jetë masa e një pensioni minimal dhe maksimal

# Klodian Muço: Sa do të rriten pensionet, kategoritë përfituese

*"Indeksimi 2.8%, preken rreth 740 mijë pensionistë"*

Voltiza Duro

Prej datës 1 prill të këtij viti, rreth 740 mijë pensionistëve nga mbarë vendi iu lind e drejta të përfitojnë një rritje pensioni prej 2.8%, bazuar në vendimin më të fundit të qeverisë. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", eksperti i ekonomisë, Phd. Klodian Muço tregon të gjitha kategoritë që do të përfitojnë nga rritja. Më tej, ai konkretizon nëpërmjet shembujve sesa do të jetë shtesa, bazuar në masën e pensionit të individit, bazuar në pensionet e llogaritura para dhe pas janarit të 2015-ës. Por eksperti ndërkohë thekson se kjo nuk është një rritje pensionesh, por një indeksim, një detyrim i Këshillit të Ministrave, që mbron pensionet nga ajo që quhet "gërryerja" e përditshme e inflacionit. Muço bën me dije për të gjithë të interesuarit që preken nga vendimi se shtesa minimale kap shifrën prej 385 lekësh të reja në muaj, ndërsa shtesa maksimale arrin në 770 lekë; kjo bazuar në masën e pensionit. Pra, sa më e madhe të jetë masa, aq më e lartë edhe shtesa e përfituar pas indeksimit me 2.8%. Sipas VKM-së, rritjen nga indeksimi në masën 2.8% e përfitojnë të gjitha kategoritë e pensioneve të pleqërisë duke nisur nga pensionet e ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore, për të vijuar te pensionet sociale, pensionet e invaliditetit përfshirë edhe invalidët e luftës, pensionet familjare, pensionet e veçanta të ushtarakëve, pensionet suplementare shtetërore të punonjësve në universitete apo qendra studimore etj.


Eksperti i ekonomisë, Phd. Klodian Muço

**740**
**MIJË PËRFITUES**
Nga indeksimi 2.8% përfitojnë rreth 638 mijë persona që trajtohen me pensionet e lartpërmendura. Nga kjo rritje po ashtu do të përfitojnë edhe rreth 100 mijë individë të tjerë, që bëjnë pjesë në skema të tjera. Pra, në total do të përfitojnë nga indeksimi rreth 740 mijë persona që jetojnë në territorin e Shqipërisë.

**1**
**PRILL**
**VENDIMI**
Duke iu referuar VKM-së, mund të themi se është marrë vendimi që pas datës 1 prill 2019, pensionet e ndryshme të pleqërisë, por jo vetëm, që përmendëm pak më parë të caktuara me ligjin nr.150/2014, që kanë datë fillimi të së drejtës deri më 31.12.2014 nuk do të jenë më pak se 13 753 lekë në muaj. Përsëri jo më pak se 13 753 lekë s'do të jenë as pensionet e parakohshme.

**385**
**LEKË RRITJA**
Pensionet e pleqërisë s'do të jenë më shumë se 27 506 lekë. Pra, indeksimi do të jetë nga 385 lekë deri në 770 lekë. Për t'iu rikthyer shembullit të Kosovës, rritja e pensioneve për 2019-ën do të jetë nga 15-34 euro. Fondi për indeksimin e pensioneve ishte parashikuar 2.45 miliardë lekë. Pak a shumë sa kosto e ndërtimit të një km autostradë në Shqipëri.

**Këshilli i Ministrave vendosi që pensionet të indeksohen në masën 2.8%. A është realizuar realisht ky indeksim?**

Nëse do të shohim indeksin e çmimeve të konsumit në kompleks për vitin 2018, të publikuar nga INSTAT, vërejmë se ky indeks u rrit me rreth 2% për 2018-ën. Në këtë rast mund të themi se Këshilli i Ministrave e ka realizuar indeksimin duke çuar edhe pensionet me më pak se 1%. Nëse do të jepnim një përgjigje pak më precize, atëherë do të duhej të shikonim indeksin e çmimeve të konsumit sipas produkteve, më konkretisht atë të produkteve ushqimore dhe pijeve joalkoolike si dhe indeksin e rritjes së nivelit të produkteve shëndetësore (pasi këto janë produktet kryesore që konsumohen nga pensionistët), në këtë rast rritja mesatare e indeksit në fjalë ka qenë 2.675%. Në të këtë rast mund të themi se Këshilli i Ministrave ka bërë një indeksim të pensioneve për të ruajtur nivelin e mirëqenies që ka qenë përgjatë 2018, pa tentuar ta përmirësojnë këtë të fundit sado pak për vitin aktual.

**Çfarë përfaqëson indeksimi i pensioneve me 2.8%?**

Shumë media vizive, të shkruara apo shumë politikëbërëse me dashje apo pa dashje e quajnë këtë indeksim një rritje të pensioneve. Pjesa dërmuese e pensionistëve, duke përfshirë edhe mamanë time lumturohen kur dëgjojnë lajme të tilla. Në realitet ky është thjesht një koeficient që mbron pensionet nga rënia e fuqisë blerëse të monedhës sonë kombëtare (inflacioni). Siç e përmenda edhe më sipër, në këtë rast edhe pse do zhgënjej shumë pensionistë, nuk kemi të bëjmë me rritje të pensioneve, thjesht kemi një indeksim të inflacionit. Për të bërë një konfront me Kosovën, një komb shqiptar si ne, por shumë më i ri si shtet. Rritja e pensioneve për 2019-ën në Kosovë u propozua të ishte 20%. Duhet të theksojmë këtu që niveli i pensioneve në Kosovë ishte dhe është më i lartë se ai në Shqipëri. Mora Kosovën për të mos e bërë edhe me tragjike situatën, për të konfrontuar pensionet shqiptare me nivelin e pensionet në Serbi apo Malin e Zi si dhe rritjen e tyre çdo vit.



**Sa është numri i individëve që do të përfitojnë nga shtesa e pensionit?**

Sipas VKM-së, rritjen nga indeksimi në masën 2.8% e përfitojnë të gjitha kategoritë e pensioneve të pleqërisë. Duke nisur nga pensionet e ish- anëtarëve të kooperativave bujqësore për të vijuar te pensionet sociale, pensionet e invaliditetit përfshirë edhe invalidët e luftës, pensionet familjare, pensionet e veçanta të ushtarakëve, pensionet suplementare shtetërore të punonjësve në universitete apo qendra studimore etj. E thënë ndryshe në numra, përfituesit nga indeksimi 2.8% janë rreth 638 mijë persona, që trajtohen me pensionet e lartpërmendura. Nga kjo rritje po ashtu do të përfitojnë edhe rreth 100 mijë individë të tjerë, që bëjnë pjesë në skema të tjera. Pra, në total do të përfitojnë nga indeksimi rreth 740 mijë persona që jetojnë në territorin e Shqipërisë si dhe ata pensionistë që përfitojnë një pension pleqërie në Shqipëri, por që jetojnë jashtë territorit shqiptar.

**Sa variojnë shifrat e rritjes së pensioneve pas 1 prillit të këtij viti?**

Duke ju referuar VKM-së, mund të themi se është marrë vendimi që pas datës 1 prill 2019, pensionet e ndryshme të pleqërisë, por jo vetëm, që përmendëm pak më parë të caktuara me ligjin nr.150/2014 që kanë datë fillimi të së drejtës deri më 31.12.2014, nuk do të jenë më pak se 13 753 lekë në muaj. Përsëri jo më pak se 13 753 lekë s'do të jenë as pensionet e parakohshme. Pensionet e pleqërisë s'do të jenë më shumë se 27 506 lekë. Pra, indeksimi do të jetë nga 385 lekë deri më 770 lekë. Për t'ju rikthyer shembullit të Kosovës, rritja e pensioneve për 2019-ën do të jetë nga 15-34 euro. Ndërsa te ne, pak a shumë rritja do të jetë sa çmimi i dy litrave naftë që i harxhojnë mesatarisht makinat e deputetëve të Republikës së Shqipërisë për të bërë rrugën nga parlamenti deri në një prej shumë restoranteve në të dalë të Tiranës. E thënë ndryshe, fondi për indeksimin e pensioneve ishte parashikuar 2.45 miliardë lekë. Pak a shumë sa kosto e ndërtimit të një km autostradë në Shqipëri. Ose, ose sa 0.0000002% e shumës që gjen KLSH çdo vit si shpërdorime të fondeve publike.

**A marrin kompensim të ardhurash pensionet e llogaritura para 1 janarit të vitit 2015-të?**

Po. Rritje do të përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen nga data 1.4.2019 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 31.3.2019, përfshirë edhe këtë datë.

**A do të ndihet indeksimi prej 2.8% tek pensionet e përllogaritura pas janarit të vitit 2015?**

Më lejo të bëj një parantezë të shkurtër. Në Shqipëri çdo pagë deri në vitin 2015 shumëzohet me një koeficient për të caktuar për të llogaritur më pas pensionin. "Pagat para 1994-ës bashkohen me pagën ose kontributin që ka derdhur secili. Për të llogaritur pensionin, në të dyja periudhat (para dhe pas 1994-ës) bashkohen dhe merret parasysh 1% e kontributit që është derdhur deri në momentin që personat dalin në pension. Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi. Për efekt të llogaritjes së pensioneve, baza e vlerësuar mesatare do të llogaritet bazuar në pagat referuese duke e indeksuar me inflacioni, sipas llojit ➔



ISSH: Si do të ndryshojë mosha e daljes në pension për burrat dhe gratë

# Kriteret dhe dokumentacioni për të marrë pensionin e pleqërisë

## *Cila është formula e saktë e përllogaritjes*

Voltiza Duro

Të moshuarit që kanë plotësuar moshën e përcaktuar me ligj dhe kenë minimumi 15 vite punë me kontribute mund të përfitojnë pension pleqërie. Aktualisht mosha e daljes në pension për gratë është 60 vjeç e 10 muaj, ndërsa në 2020 do të jetë 61 vjeç. Sakaq, burrat duhet të jenë mbi 65 vjeç, në mënyrë që të mund të marrin këtë lloj pagese (mosha fillon rritet që nga viti 2033 me nga 1 muaj në vit për të arritur në 67 vjeç në vitin 2056). Sipas reformës së re të vitit 2014-të, masa e përllogaritjes së pensionit varet nga vitet e punës dhe paga, pra pensioni është produkt i viteve të sigurimit dhe pagës mbi të cilin janë paguar kontributet. Sa më shumë vite të ketë aplikanti dhe sa më e lartë të ketë qenë paga e tij, aq më e lartë do të jetë masa e përfitimit. Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se vjetësia e plotë e kontributeve për të dyja gjinitë është 35 vite e 8 muaj, e cila rritet me 4 muaj në vit, për të arritur me 40 vite në vitin 2029.

**PËRLLOGARITJA**

| 292 | KISHA ORTHODOKSE AUTOQEFALE E | | | 109.2 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 293 | ARJAN | GANI | DUZHA | 267.6 |
| 294 | ENGLA | MYSLI | TOROMANI | 279 |
| 295 | FLAMUR | JONUZ | TASHI | 155.7 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 296 | ARDJAN | REXHE | BEDELI | 192.3 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 297 | BARDH | ZENUN | AHMATI | 248.7 |
| | GURIJ | REFAT | AHMATI | |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 298 | SHYQY | SHERI | POKA | 119.7 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 299 | ARDIT | SALI | SPAHIU | 81.3 |
| DREJTORIA E ALUIZNI-t TIRANA JUG | | | | |
| QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE | | | | |
| 300 | NAZMI | IDRIZ | SHOKU | 300.9 |
| DREJTORIA E ALUIZNI-t FIER | | | | |
| QARKU FIER , ZONA KADASTRALE 3358 SH. MARINAS | | | | |
| 301 | PANDEL | KRIST | LENA | 522 |
| 302 | PANDEL | KRIST | LENA | 222 |
| 303 | PANDEL | KRIST | LENA | 972 |
| 304 | PANDEL | KRIST | LENA | 3278 |
| 305 | PANDEL | KRIST | LENA | 1408 |
| 306 | PANDEL | KRIST | LENA | 580 |
| QARKU FIER , ZONA KADASTRALE 8533 ZVRPP FIER | | | | |
| 307 | SHEHE | SULEJM | HOTI | 423.3 |
| 308 | TAHIR | ASLLA | HETEMAJ | 427 |
| 309 | HAJROS | FERIZ | KAJOLLI | 286 |
| 310 | HAXHI | HAMIT | CAKERRI | 288 |
| 311 | BASHKI | SHYQY | ELMAZAJ | 405.9 |
| 312 | BESNI | MUSTA | MALOKU | 718 |
| 313 | HAXHI | FEJZI | FERKO | 323 |
| 314 | TAHIR | ASLLA | HETEMAJ | 427 |
| 315 | SHEHE | SULEJM | HOTI | 423.3 |
| QARKU FIER , ZONA KADASTRALE 8532 ZVRPP FIER | | | | |
| | GEZIM | SELADI | DERVISHI | |
| | ARDIA | SELADI | DERVISHI | |
| 316 | MANUE | SELADI | DERVISHI | 450 |
| 317 | PELLUM | MYSTEH | ALUSHAJ | 307 |
| 318 | VALENTI | KRIST | DEVIJA | 124 |
| 319 | KOZM | KOLI | GJONI | 463 |
| 320 | NATASH | BARJA | HEBEJA | 90.5 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 321 | ARQIL | JOTI | DASHI | 240 |
| 322 | VIOLETA | HARED | DURAJ | 43 |
| 323 | VIKTO | LONI | MILE | 70 |
| 324 | ADMIRI | RAPI | KERRI | 276 |
| | REDIA | RAPI | KERRI | |
| 325 | NORIS | DILAVE | DERVISHAJ | 226 |
| 326 | RAMAZA | FEJZU | GURGURI | 219.8 |
| 327 | VASIL | TODI | PRIFTI | 357 |
| 328 | JORGJ | PETRO | MERTIRI | 290 |
| 329 | ARBE | ENVER | ISUFAJ | 227.8 |
| 330 | PANDEL | DUD | KOLA | 129.6 |
| 331 | ALTIN | PANDE | MERTIRI | 184 |
| 332 | SOKRAT | LLAZI | KOLA | 217.2 |
| QARKU FIER , ZONA KADASTRALE 3981 ZVRPP FIER | | | | |
| 333 | KRIST | RUSTE | SINASI | 337 |
| 334 | BESIM | NURE | MANAJ | 374 |
| 335 | FAIK | ALI | DRIZA | 355 |
| 336 | VLADIMI | SADIK | IDRIZAJ | 331 |
| 337 | AGUR | MYSTEH | HATIJA | 228 |
| 338 | ALBANA | ENVER | KABASHI | 258 |
| QARKU FIER , ZONA KADASTRALE 8534 ZVRPP FIER | | | | |
| 339 | HASA | MEMET | ELMAZAJ | 317 |
| 340 | BASHKI | SAFET | KAMBERAJ | 500 |
| 341 | SELAM | QERIM | SALAJ | 103 |
| 342 | MYLAZI | SABRI | GASHI | 354 |
| 343 | GEZIM | SELIM | HILAJ | 424 |
| 344 | ARBE | MATO | BUDAJ | 363.2 |
| 345 | LEONA | RESMI | GEGA | 359 |
| 346 | EDMON | MITI | PJETRI | 213 |
| 347 | DILAVE | ISMAIL | SHESHALLIU | 340.2 |
| 348 | PANDEL | DHANI | GJATA | 200 |
| 349 | VANGJE | LONI | KOLA | 279 |
| | LEONA | VANGJ | KOLA | |
| 350 | ERVIN | RAKO | SHTEMBARI | 316.6 |
| 351 | XHEVI | MUSTA | SULAJ | 322 |
| 352 | FASLLI | RAMO | ALUSHAJ | 371 |
| 353 | SHPETI | REFAT | KASA | 308 |
| 354 | THOM | PALI | NUSHI | 405 |
| 355 | LEDIO | SELAM | SALAJ | 161.1 |
| | LAURET | TODI | FILIPI | |
| | GENTIA | VILSO | FILIPI | |
| 356 | ENEA | VILSO | FILIPI | 300 |
| 357 | KASTRI | TEKI | HADUSHAJ | 297 |
| 358 | ARIST | PETRI | KUQI | 450 |
| 359 | FERDIN | KAMBE | SUBASHAJ | 329 |
| 360 | AGIM | HALIL | SMAKA | 222 |
| 361 | LEONA | PETRIT | SALAJ | 406 |
| 362 | MARIGL | LILI | PIPA | 221.9 |
| 363 | MEHME | NEZET | SALIAJ | 300 |
| 364 | PETRAQ | VASIL | NAKA | 331 |
| 365 | AGRO | FANI | MONE | 283 |
| QARKU FIER , ZONA KADASTRALE 3031 ZVRPP FIER | | | | |
| 366 | MIRESIJ | VELI | HATELLARI | 351 |
| 367 | SHKEN | SHABA | HOXHAJ | 170 |
| 368 | SHKEN | SHABA | HOXHAJ | 889 |
| 369 | FEIM | ISMAIL | BRAHUSHAJ | 323 |
| 370 | YLLI | RUSTEM | CANAJ | 498 |
| 371 | HAMIT | MUHAME | BRAHUSHAJ | 308 |
| 372 | SKENDE | XHEPO | BRAHUSHAJ | 407 |
| 373 | RAMIS | SKENDE | BRAHUSHAJ | 448 |
| 374 | THANAS | QEMAL | XHOKAXHI | 411 |
| QARKU FIER , ZONA KADASTRALE 1634 fshati Frakull e | | | | |
| DREJTORIA E ALUIZNI-t DURRES | | | | |
| QARKU DURRES , ZONA KADASTRALE 1925, ZVRPP | | | | |
| 376 | SAJMIR | JUSUF | FARRICI | 400 |
| QARKU DURRES , ZONA KADASTRALE 3385, ZVRPP | | | | |
| 377 | MARIGLE | GEZIM | JAHOLLARI | 200 |
| | GEZIM | HYSEN | JAHOLLARI | |
| QARKU DURRES , ZONA KADASTRALE 3542, ZVRPP | | | | |
| 378 | NARDI | ZINI | HOXHA | 90 |
| | FIKE | BAJRAM | HOXHA | |
| 379 | NARDI | ZINI | HOXHA | 71 |
| | FIKE | BAJRAM | HOXHA | |
| QARKU DURRES , ZONA KADASTRALE 8518, ZVRPP | | | | |
| 380 | JOLLAND | SOTIR | SHAHAJ | 19 |
| QARKU DURRES , ZONA KADASTRALE 8516, ZVRPP | | | | |
| 381 | JANI | ANDON | COMOLLARI | 138 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 382 | LEFTER | ANDON | COMOLLARI | 137 |
| 383 | BUJAR | QEMAL | PAPUSHALLAI | 456 |
| 384 | SHPRE | HAXHI | TURKU | 391 |
| QARKU DURRES , ZONA KADASTRALE 8514, ZVRPP | | | | |
| 385 | HATE | XHEMAL | BERHOMI | 17 |
| | MERIT | ABDYL | BERHOMI | |
| QARKU DURRES , ZONA KADASTRALE 8511, ZVRPP | | | | |
| 386 | RITVA | AGRON | GJEVORI | 410 |
| | MIRJET | AVDYL | GJEVORI | |
| 387 | BAJRAM | HASAN | DUNGA | 522 |
| DREJTORIA E ALUIZNI-t TIRANA RURALE | | | | |
| QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 2380, ZVRPP TIRANI | | | | |
| QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 3550, ZVRPP TIRANI | | | | |
| QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 1604, ZVRPP TIRANI | | | | |
| 388 | ARJAN | FERIK | ÇULLHAJ | 223.5 |
| 389 | HAXHI | ALUSH | RRAHMANI | 262.2 |
| 390 | HAMDI | MUSTA F | TOSHI | 316.8 |
| QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 1605, ZVRPP TIRANI | | | | |
| 391 | BAJRAM | MEDI | BASHA | 356.4 |
| | ASLLAN | DEMUSH | | |
| 398 | SADRI | HYS | DARSI | 350 |
| QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 1604 | | | | |
| 399 | ISLAM | BAJRA | AHMETI | 293.7 |
| QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 2105 | | | | |
| 400 | MENTO | RAMAD | SHIRA | 350.4 |
| QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 3064 | | | | |
| 401 | RIDVA | KAMBE | MILLOSHI | 262.2 |
| QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 2951 | | | | |
| 402 | ASTRI | MERSI | CELMETA | 370 |
| QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 2953 | | | | |
| 403 | ARBEN | FETAH | METKO | 421.5 |
| 404 | KUJTIM | TERXHA | LENA | 492.9 |
| | AGRON | KUJTIM | LENA | |
| 405 | SULEJMA | DEMIR | KALAJA | 419.4 |
| QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 3866 | | | | |
| 406 | RIZA | SERVET | XHEPA | 264.3 |
| 407 | SERVET | TAHIR | XHEPA | 297 |
| | ARTAN | SERVET | XHEPA | |
| 408 | MUNIR | ISUF | PUCI | 266.1 |
| 409 | SADIK | HAJREDI | CERA | 234.9 |
| 410 | ZAMBAK | CAUSH | DINOSHI | 159.3 |
| 411 | HAJREDI | QERIM | ISTREFI | 198.8 |
| 412 | FERIT | MAN | CERA | 500 |
| 413 | LIRI | NUREDI | BARDHI | 110.8 |
| 414 | ERVIS | QEMAL | SHABANAJ | 288.6 |
| 415 | FATIME | SEID | SALLAKU | 261 |
| 416 | DRITAN | HASAN | STAFA | 288 |
| 417 | SKENDE | HALIL | ALMADHI | 419.4 |
| 418 | BEQIR | HAMID | MANSAKU | 309.4 |
| 419 | HIKE | SALI | HAROKU | 246.3 |
| 420 | SANIJE | JONUZ | LEKA | 294.3 |
| | DYLBIN | NEBI | LEKA | |
| 421 | KASAM | DAN | DANI | 500 |
| 422 | NDUE | ZEF | DODA | 289.5 |
| 423 | IMERLI | SADIK | ÇUNI | 240.9 |
| 424 | HIQME | ALI | ALIA | 275.1 |
| 425 | SADRI | RIZA | FERATI | 312.3 |
| 426 | MEXHI | MUSTA | LOSHA | 248.4 |
| 427 | NIKOLL | GJIN | KADRIJA | 308.4 |
| 428 | GANI | ASLLA | BRATA | 351 |
| 429 | FATJON | KADRI | XHIXHA | 226.8 |
| 430 | BALI | HALIL | JAHELEZI | 273.3 |
| 431 | GZIM | GJON | NIMANI | 295.5 |

GAZETA SHQIPTARE
# Life pages
Suplement
E hënë 1 Prill 2019 REDAKTOR: VOLTIZA DURO

## YLLI MERJA:



Si të trajtoni infeksionet e rënda të veshkave brenda 2 muajsh

## KESHILLA



Mënyra praktike për të parandaluar dhimbjen e mesit

# LORELA GARULI:

Psikologia: Shembujt konkretë të ngjyrave në piktura, emocionet që përcjellin



## Si të kuptoni gjendjen psikologjike të fëmijëve nëpërmjet vizatimit

"Format që sinjalizojnë çrregullime te vogëlushët"

## Luleshtrydhet, aleatet më të mira për shëndetin e lëkurës

Psikologia: Shembujt konkretë të ngjyrave në piktura, emocionet që përcjellin

# LORELA GARULI:

## Si të kuptoni gjendjen psikologjike të fëmijëve nëpërmjet vizatimit

### "Format që sinjalizojnë çrregullime te vogëlushët"

Voltiza Duro

Vizatimi si një instrument matës është i vlefshëm në çdo moshë, por përdorimi i tij në fëmijërinë e hershme është një nga instrumentet më të përdorura, për arsyen e thjeshtë se është një nga aktivitetet kryesore të kësaj grupmoshe krahas lojës. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", psikologia Lorela Garuli tregon mënyrat që të mund të kuptoni fëmijën nëpërmjet vizatimeve që ai realizon. Ajo sqaron me shembuj konkretë domethënien dhe gjendjen emocionale në të cilën ndodhen vogëlushët, bazuar në ngjyrat dhe format që përdorin në vizatimet e tyre.

**Çfarë tregojnë pikturat që fëmijët bëjnë për personalitetin e tyre dhe sa mund të kuptosh fëmijën përmes vizatimit?**

Vizatimi te fëmijët, ashtu si të gjitha format e tjera të zhvillimit intelektual, shprehet sipas disa stadeve e hapave që janë në përputhje me moshën dhe nivelin mendor të tij. Është një matës shumë i mirë i disa elementëve të zhvillimit: i motorikës, iniciativës, imagjinatës, lirshmërisë, shkathtësisë, mprehtësisë, mënyrës sesi percepton dhe pasqyron botën, i informacioneve që fëmija ka mbi tema të caktuara, kontekstit social, kulturor dhe ekonomik të tij. Qëllimi kryesor i të vizatuarit nga fëmija brenda një konteksti shkollor ose terapeutik është pa dyshim vlerësues. Vlerësues në mbledhjen e informacioneve dhe të të dhënave lidhur me fëmijën, informacione që vështirësisht mund të merren në rrugë të tjera si në punën me të rriturit. Sigurisht që për nga natyra e tyre, me fëmijët është e vështirë, thuajse e pamundur të zhvillohen intervista, t'u drejtohen pyetje me synim marrjen e përgjigjeve, që do të thotë se mënyra e vetme për të ndërtuar marrëdhënien terapeutike do të jetë në rrugë joverbale, konkretisht nëpërmjet vizatimit dhe lojës. Për më tepër, informacioni që vjen në rrugë joverbale është më afër së vërtetës, duke qenë se te fjalët individi ka një nivel më të lartë kontrolli dhe manipulimi. Fakti që vizatimi si shprehje grafike bën pjesë te komunikimi joverbal, i shton vlefshmërinë e përdorimit edhe në kontekste terapeutike me fëmijën, si rrjedhojë e thellësisë së informacionit që ky i fundit sjell.


Psikologia Lorela Garuli

**Në çfarë moshe mund të analizohen vizatimet e fëmijëve?**

Vizatimet mund të konsiderohen si një burim domethënës informacioni mbi personalitetin e fëmijëve që prej çasteve të para kur këta të fundit nisin të vizatojnë. Fëmija do të nisë të vizatojë vija dhe harqe, sa për t'u ushtruar, që nuk kanë kuptime të veçanta emocionale për të, por janë pjesë të formave konkrete të asaj që ai sheh përreth. Më tej do të vizatojë objekte, veten,



njerëz, personazhe jo vetëm ashtu siç ata janë në të vërtetë, por mbi të gjitha ashtu si ai i sheh, vizatime pra që pasi përpunohen nga ndërgjegjja dhe sytë e tij, do të vijnë shumë origjinalë.

**A kanë rëndësi ngjyrat që përdorin në vizatime vogëlushët?**

Nëse do të vlerësonim në bazë të ngjyrave të cilat përdor më shumë fëmija, do të kuptonim disa veçori të caktuara. E verdha do të shprehë sipërfaqësi, dinamizëm, lëvizje, liri, ekstraversion, kureshtje. Bluja qetësi, ngurrim, një ftohtësi në nivel emotiv. E kuqja më shumë se çdo ngjyrë tjetër është shprehëse e gjallërisë, lëvizjes, pasionit, emocionit, kurajës, deri agresivitetit, që sipas kontekstit mund të jetë tregues i një mungese kontrolli, dhune e shpërthime inati. Vizaton me ngjyra të errëta kur ndjen dhimbje, zemërim, trishtim. Këto janë vetëm disa shembuj në morinë e shprehjeve grafike të fëmijëve, që nëpërmjet vizatimit flasin për botën e tyre shpirtërore dhe mendore.

**Cilat mund të vlerësohen disa prej vizatimeve që shprehin më së miri botën e fëmijëve?**

Më konkretisht, ka disa vizatime që fëmijët mund të bëjnë dhe mbartin një simbolikë të caktuar. Një ndër kryesorët është vizatimi i pemës. Të vizatosh pemën do të thotë të bësh një lloj autoportreti. Nis me rrënjët që përfaqësojnë mënyrën sesi i përqasemi mjedisit tonë, vazhdon me trungun si baza dhe pjesa më e qëndrueshme e personalitetit, duke përfunduar me kurorën e degët e pemës, që janë si një "çati". Nëse do të paralelizohej me trupin njerëzor, do të simbolizonte kokën, pra të menduarit racional. Rrënjë të thella shprehin lidhje të fortë me nënën, prania e frutave dhe luleve ka të bëjë me shprehi të mira sociale dhe prani potencialesh, me gjethe që bien shpreh boshllëk emocional e me radhë. Vizatime të tjera të rëndësishme janë: figura njerëzore, shtëpia dhe familja. Fëmija e vizaton veten të madh apo të vogël në fletë, në varësi dhe të rolit që ai ka në familje. Zgjedh të vizatojë më të madh personazhin që do më shumë apo që ka më ndikim në jetën e tij. Vizaton një shtëpi të madhe me shumë dyer e dritare kur jeton një familje që i siguron afeksion e dashuri. E bën veten të vogël kur ndihet i parëndësishëm. Vizaton një çati të madhe kur është shumë ëndërrimtar e kështu me radhë.



**Cilët janë elementët që tregojnë që fëmija mund të ketë çrregullime?**

Përtej të kuptuarit të elementëve të ndryshëm të personalitetit, karakterit, temperamentit, sesi fëmijët shohin marrëdhëniet sociale, si e konceptojnë familjen dhe veten, nëpërmjet vizatimeve mund të kuptojmë dhe aftësitë e veçanta apo talentet. Fëmijë që vizatojnë të njëjtën gjë në mënyrë të përsëritur, vizatime ku mungon harmonia, forma, rregulli, kufijtë, vizatime që paraqesin figura të çuditshme abstrakte janë karakteristike për fëmijë me nevoja të veçanta apo çrregullime të zhvillimit. Në të kundërt, vizatime e piktura shumë të sofistikuara, me një thellësi shprehjeje e mendimi, me një gjuhë simbolike të pasur, me një kombinim estetik e artistik të ngjyrave dhe detajeve do të na japin të dhëna për fëmijë, të cilët vizatimin e kanë talent që mund ta zhvillojnë më vonë dhe si profesion.

**Si e vlerësoni komunikimin prind-fëmijë në ditët e sotme?**

Marrëdhënia prind-fëmijë është ndër marrëdhëniet themelore, që përcakton shumë aspekte të identitetit tonë dhe fatin e shumë marrëdhënieve më vonë në jetë. Për pasojë, përtej durimit, prindërit duhet në radhë të parë të komunikojnë sa më shumë me fëmijët. Komunikimi është shtylla kurrizore e çdo marrëdhënieje njerëzore, ndaj fëmijët duhen dëgjuar, respektuar dhe lënë të lirë të zhvillojnë të gjitha potencialet e veta si të ishin të rritur.

# Këshilla



## Qumështi i bletës, "ilaçi i mrekullive"



Qumështi i bletës është "ilaçi i mrekullive", pasi ka efekte kuruese për të gjitha moshat dhe shëron disa nga sëmundjet që vuajnë pjesa më e madhe e popullsisë. Ai ka efekt qetësues dhe çlodhës, ul nivelin e hormoneve të tiroides, ndihmon zhvillimin dhe rritjes, stimulon gjëndrat seksuale, ndihmon prodhimin e vezoreve gjatë shtatzënisë, duke rritur nivelin e progesteronit në gjak. Gjithashtu, qumështi i bletës rrit nivelin e testosteronit në gjak, duke ndihmuar në problemet e potencës mashkullore, stimulon gjëndrat mbiveshkore, ndihmon në sëmundje si artriti ose lodhja kronike, ul zmadhimin e prostatës. Ka të njëjtin efekt si hormonet femërore, normalizon punën e testikujve, ndihmon në funksionimin e mëlçisë dhe sëmundjet e saj, rigjeneron strukturën e mëlçisë. Ka efekt antiinflamator (si Paracetamoli, Advili), pastron organizmin nga toksinat, ndihmon funksionimin e veshkave, rrit jetëgjatësinë e njerëzve duke ruajtur rininë e enëve të gjakut, zgjeron enët e gjakut, ndihmon në uljen e kolesterolit dhe triglicerideve, rrit imunitetin. Ndërkohë, qumështi i bletës ndihmon edhe në formimin e rruazave të kuqe të gjakut dhe këshillohet në rastet e anemisë. Por, gjen përdorim edhe në kozmetikë, sepse ndihmon në pastrimin dhe rinimin e lëkurës. Përdoret si agjent antibakterial dhe antivirusal lokal për probleme të ndryshme të lëkurës, ndërsa te fëmijët e sapolindur ndihmon në rritjen në peshë. Kura duhet të zgjasë një muaj, maksimumi tre muaj, për dozat lexoni me kujdes letrat që e shoqërojnë dhe respektoni indikacionet e shkruara. Rezultatet e kurës mund të shfaqen menjëherë ose me pak vonesë, sepse ndryshe nga poleni, qumështi i bletës vepron më ngadalë.

Kur nuk duhet të përdoret

Qumështi i bletës nuk duhet të përdoret në kriza astme, sepse mund të ngushtojë bronket, gjë që do ta rëndonte sëmundjen. Gjithashtu, nuk duhet ta përdorin ata që vuajnë nga sëmundja Addison, si dhe ata që kanë kancer në fazë akute.

*EFEKTET ANËSORE*

Dhembje stomaku, të vjella, diarre dhe pagjumësi (kjo e fundit ndodh më shpesh te femrat). Në të tilla raste, në fillim ulni dozën dhe nëse efektet anësore nuk përmirësohen, ndërprisni konsumimin. Kujdes, nëse nuk respektoni dozat, mund të jetë helmues! Duhet pasur kujdes në përdorim kur organizmi është tepër i dobësuar, është e pamundur tretja e qumështit. Kur vuani nga sëmundje me spazma të tubit tretës, kancer shumë të përhapur në lëkurë.



## Luleshtrydhet, aleatet më të mira për shëndetin e lëkurës

Luleshtrydhja është një frut që ka shumë pak kalori, është një aleate e shkëlqyeshme për bukurinë dhe shëndetin e lëkurës. Ajo është një mënyrë e mirë për pastrimin dhe ushqimin e lëkurës, me ndihmë të vitaminës C dhe A. Përmbajtja e saj e mban lëkurën e butë dhe të tendosur. Është e rëndësishme që një herë ose dy herë në javë të vendosni në fytyrë luleshtrydhe të prera në rrathë, ose të bëni prej tyre maskë të butë, të cilën më pas do ta shpëlani së pari me ujë të vakët dhe pastaj me ujë të ftohtë. Nëse i pastroni dhëmbët me to, do t'i hiqni shtresat e mbledhura dhe dhëmbët do t'i bëni më të bardhë. Luleshtrydhja ka një efekt të pazëvendësueshëm në luftën kundër celulitit. Vitaminat A dhe C janë antioksidante dhe ato e ngadalësojnë plakjen dhe humbjen e elasticitetit të indeve, shkatërrojnë radikalet e lira, prandaj konsumi i rregullt i dredhëzave do ta përshpejtojë qarkullimin e gjakut dhe do të ndihmojë në luftën kundër armikut të urryer të shumë femrave. Megjithatë, nëse jeni duke bërë luftë të vazhdueshme me peshën e tepërt, do të gëzoheni kur të dëgjoni se luleshtrydhet e përshpejtojnë metabolizmin, reduktojnë oreksin dhe kanë pak kalori. Nëse dëshironi që të keni përfitimet e duhura në lidhje me maskën e fytyrës, ekzistojnë tri mënyra të ndryshme që ju mund ta realizoni një gjë të tillë si:

**Luleshtrydhe me mjaltë**

2-3 lugë pure luleshtrydheje përzieni me një lugë të vogël me mjaltë. Aplikoni përzierjen në fytyrë, pastaj shpëlani pas 20 minutash. Bëjeni këtë një herë ose dy herë në javë për ta pasur një lëkurë rrezatuese.

**Luleshtrydhe me limon**

Kombinimi i limonit dhe i luleshtrydhes është shumë i mirë për fytyrën. Merrni gjysmë gote me luleshtrydhe pure dhe pastaj shtrydhni limonin në të. Aplikoni përzierjen në fytyrë dhe lëreni për 10 minuta. Shpëlajeni dhe lëkura juaj do të jetë e bukur dhe e butë.

**Luleshtrydhe me kos**

Merrni 3-4 lugë të vogla me luleshtrydhe të shtypura dhe përzieni me 1-2 lugë të vogla kos. Aplikoni atë në tërë fytyrën dhe shpëlani pas 15 minutash. Masazhoni butë lëkurën pas larjes. Luleshtrydhet do të bëjnë që fytyra juaj të duket më e re.

Vrau avokatin Zafiropoulos, dalin pamjet e ekzekutimit të shqiptarit në qeli

# Video horror, si u masakrua shqiptari në burgun grek

## E therën në bark, gardianët nuk reaguan ndaj skenës

Ditën e djeshme është postuar një video e rëndë me skena dhune e grushte në bark, në një vend që dëshiron të quhet i civilizuar, shkruan "tanea.gr". Kjo video është dokument i një krimi horror në burgun grek të Koridhalos, i cili tregon vrasjen e një të burgosuri shqiptar. Në video shfaqet dhuna midis të burgosurve në korridoret e burgut, ndodhur më 14 janar të këtij viti, ku humbi jetën shqiptari Albert Bako, 37 vjeç. Shqiptari ecën nëpër korridor dhe sulmohet nga dy të burgosur të tjerë. Oficerët e burgut duken të paaftë për të ndërhyrë dhe nuk bëjnë thuajse asgjë. Në fund të videos viktima duket në një barelë dhe transferohet në spitalin e burgut. Një situatë që të kujton Meksikën dhe Kolumbinë. Gazeta greke "TaNea" shkruan se muajt e fundit në Koridhalo kanë ndodhur rreth 10 përplasje të përgjakshme, 26 vdekje të dënuarish për shkaqe të ndryshme dhe dhjetëra plagosje, disa prej të cilëve shqiptarë. Albert Bako sapo ishte transferuar në burgun e Koridhalos në Greqi nga burgu i Hania dhe u vra nga të dënuar të tjerë. Transferimi i tij ishte marrë vesh nga disa anëtarë të një bande rivale, të cilët e futën në kurth dhe e vranë. Ai ishte i dënuar për sulmin që bëri në Mikrolimano, në një lokal në nëntor të vitit 2014, ku u plagosën 14 persona dhe shkaku i konfliktit ishte një kërcimtare. Gjithashtu, ai është përfshirë edhe në vrasjen e avokatit grek, Jorgos Antonopoulos, me porosi të një personi të tretë për një çështje korruptive. Bako pritej të dilte përpara gjykatës për vrasjen e avokatit grek, Mihali Zafiropoulos, pasi për këtë çështje ai dyshohej si porositës i krimit. Ndërkaq, kujtojmë se shqiptari i vrarë në burgun e Greqisë, Albert Bako nuk është i panjohur për mediat dhe policinë greke. 37-vjeçari shqiptar, Albert Bako ishte nën hetim për vrasjen e avokatit grek, Mihal Zafiropoulos, ngjarje kjo që shkaktoi reagime të forta në shtetin fqinj. Për këtë rast ai është pyetur më parë nga policia dhe bëri këtë deklaratë: "Unë nuk doja ta vrisja avokatin Mihal Zafiropoulos, doja vetëm ta trembja". Ai sapo ishte transferuar nga burgu i Hania në atë të Koridallos, por ky transferim rezultoi fatal për jetën e shqiptarit. Mediat greke raportojë se pas vrasjes së Bakos qëndron një bandë rivale, e cila kishte mësuar për transferimin e 37-vjeçarit. Momenti i arrestimit të shqiptarit u publikua nga të gjitha mediat, ndërsa Bako deklaroi se disa persona e kishin paguar 3 mijë euro për ekzekutimin e avokatit të njohur grek. Shqiptari i ekzekutuar ishte pjesë e një grupimi nacionalist me rreth 145 mijë anëtarë në rrjetet sociale, të cilët kishin si "betim" hakmarrjen ndaj Greqisë për vrasjen makabre të shqiptarit Ilia Kareli në burgun e Nigritas. Kujtojmë se në 14 janar të këtij viti doli lajmi se një shqiptar është vrarë në një nga burgjet e Greqisë. Sipas mediave fqinje, shqiptari që ka humbur jetën është Albert Bako. E përditshmja greke "Protothema" njoftoi se Bako sapo ishte transferuar në burgun e Kardhialos, ndërsa pas vrasjes së tij dyshohet se qëndron një bandë rivale, e cila kishte mësuar transferimin.


Pamje nga sulmi me thikë të të burgosurit shqiptar në Greqi

**DYSHIMET**
Mediat greke raportojë se pas vrasjes së Bakos qëndron një bandë rivale, e cila kishte mësuar për transferimin e 37-vjeçarit. Momenti i arrestimit të shqiptarit u publikua nga të gjitha mediat, ndërsa Bako deklaroi se disa persona e kishin paguar 3 mijë euro për ekzekutimin e avokatit të njohur grek.

**SKENA MAKABRE**
Shqiptari ecën nëpër korridor dhe sulmohet nga dy të burgosur të tjerë. Oficerët e burgut duken të paaftë për të ndërhyrë dhe nuk bëjnë thuajse asgjë. Në fund të videos, viktima duket në një barelë dhe transferohet në spitalin e burgut.

## SHKURT

### Kosnett: Kosova ka sukses kur gratë udhëheqin

Ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett, deklaroi dje se Kosova ka sukses kur gratë udhëheqin. Përmes një postimi në "Twitter", Kosnett shprehet se përmes udhëheqjes së femrave mund të festohen kontributet e grave në Kosovë. "Muajin e kaluar kam ndarë tregimet e shumë grave që janë udhëheqëse në Kosovë. Unë ju ftoj të ndani udhëheqësit që ju frymëzojnë - përdorni fjalën 'WomenLeadKS' (femrat drejtojnë Kosovën), kështu që ne mund të festojmë kontributet e grave në Kosovë!", shkruan diplomati amerikan në "Twitter".

### Ish-ministrja serbe: Më shkarkuan se s'mendoj si kryeministri

Vesna Mikiç, e pushuar nga posti qeveritar nga kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se shkarkimi i saj ka ardhur pasi shefi i qeverisë nuk dëshiron të ketë serbë në institucione, që mendojnë me kokën e tyre. Ajo ka thënë se nga institucionet e Kosovës po largohen serbë që nuk dëshirojnë të jenë vetëm dekor në institucionet e Kosovës. Mikiç ka thënë se ka treguar një të vërtetë kur ka folur për "gjenocidin e NATO-s ndaj popullit serb". "E vërteta, sipas jush është vetëm ajo që ju përshtatet dhe vetëm ajo që dëshironi të dëgjoni", ka shkruar ish-zëvendësministrja e Drejtësisë në letrën drejtuar Ramush Haradinajt. Kjo zyrtare e Listës Srpska ka thënë se qëndron prapa fjalëve të thëna në rrjetet sociale se bashkësia ndërkombëtare kishte sulmuar një shtet sovran, pa miratimin e OKB-së dhe në mospërputhje me rregullat ndërkombëtare. Ramush Haradinaj e ka shkarkuar Vesna Mikiçin vetëm një ditë pasi ajo foli kundër sulmeve të NATO-s, të kryera para njëzet vitesh, në kohën kur Serbia vrau mbi dhjetë mijë njerëz, dëboi më shumë se një milion shqiptarë nga Kosova dhe dogji gjysmën e Kosovës.

### Hoxhaj: Të hiqet taksa, preken raportet me SHBA e BE

# Zëvendëskryeministri kosovar: Tarifa e ka goditur ekonominë serbe, të pezullohet

Pas vendimit të qeverisë në nëntorin e vitit të kaluar për vendosjen e taksës për produktet që vijnë nga Serbia dhe Bosnja është arritur efekti i synuar. Dëmi i shkaktuar ndaj Serbisë për këtë periudhë është mbi 150 milionë euro - tha zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj. Ai u shpreh se me vendosjen e taksës, Kosova i ka dhënë përgjigje të plotë Serbisë se është shtet i pavarur dhe sovran. Por, njeriu i tretë në qeveri thotë se taksa duhet të pezullohet, në mënyrë që të mos lëndohen raportet me Amerikën e BE-në. "Unë mendoj që taksa e ka arritur efektin e saj, meqë ka goditur ekonominë e Serbisë. Tani që flasim, dëmi i ekonomisë serbe është mbi 150 milionë euro dhe se Serbia ka bërë përpjekje që ta përdorë buxhetin e Kosovës për të tërhequr njohje, por të korruptuar qeveri të ndryshme në botë. Unë mendoj që me këtë, ne ia kemi dhënë një përgjigje të plotë Serbisë", tha Hoxhaj për "Ekonomia Online". "Por, fakti që taksa po lëndon raportet tona me Amerikën, me BE dhe po bllokon një proces siç është dialogu, i cili do të mund t'i shërbente Kosovës, është mirë që të shohim se si të ecim përpara. Qëndrimi ynë është që taksa të pezullohet për një kohë për 120 ditë dhe kjo t'i japë mundësi arritjes së një marrëveshjeje finale. Nëse kjo nuk ndodh, atëherë taksa do të duhet të rikthehet. Dialogu duhet të vazhdojë - thotë Hoxhaj - Kosova duhet ta përmbyllë ndërtimin e shtetit". Ai insiston se bllokada dhe dështimi i dialogut nuk është në interes të Kosovës. "Unë mendoj që është mbi të gjitha në interes të Kosovës, por edhe të Serbisë që ne ta vazhdojmë dialogun që të marrim njohjen e ndërsjellë dhe të arrijmë anëtarësimin e Kosovës në OKB. Që pas 11 vitesh nga pavarësia, pas 20 vitesh nga liria, ta përmbyllim shtetndërtimin tonë. Bllokada dhe dështimi i dialogut nuk është në interes të Kosovës, por kjo nuk është temë që i takon vetëm një pjese të politikës në Kosovë, vetëm një partie politike. Unë mendoj që për interesa strategjike duhet të jemi një dhe duhet të lëvizim përpara". Hoxhaj thotë se në korrik të këtij viti kosovarët do të marrin nga BE-ja vendimin pozitiv për liberalizimin e vizave.



**ENVER HOXHAJ**
"Taksa e ka arritur efektin e saj, meqë e ka goditur ekonominë e Serbisë. Tani që flasim, dëmi i ekonomisë serbe është mbi 150 milionë euro dhe Serbia ka bërë përpjekje që ta përdorë buxhetin e Kosovës për të tërhequr njohje, për të korruptuar qeveri të ndryshme në botë. Unë mendoj që me këtë, ne i kemi dhënë një përgjigje të plotë Serbisë", tha Hoxhaj.

## Berluskoni shpall kandidaturën për deputet në PE

# Ish-kryeministri i Italisë: Dua ta kthej Europën me politikë të jashtme të përbashkët

Dëshiron të luftojë për një BE më të bashkuar, ky është arsyetimi i përdorur nga ish-kryeministri i Italisë, Silvion Berluskoni, pas njoftimit që do të garojë në zgjedhjet e Parlamentit Europian. Berluskoni, 82-vjeçar, e bëri publik lajmin për pjesëmarrjen e tij në zgjedhjet e Parlamentit Evropian gjatë konventës së partisë së tij të qendrës së djathtë, Forza Italia, e cila ka humbur mbështetjen vitet e fundit, për shkak se votuesit kanë zgjedhur parti të tjera të djathta, që kanë diskutim të antimigrantëve dhe janë euroskeptikë, siç është Partia Liga. Kjo parti udhëheq Italinë dhe është në koalicion me lëvizjen "Pesë Yjet". Partitë e koalicionit qeverisës në Itali dëshirojnë që të ndalin procesin e integrimit evropian dhe që fuqia të rikthehet te qeveritë e shteteve të BE-së. Por, Berluskoni tha se dëshiron pikërisht të kundërtën. Ai tha se dëshiron që Evropa të "rikthehet në projektet e themeluesve të saj, të cilët dëshironin një Evropë më të bashkuar, një Evropë me një politikë të jashtme të përbashkët dhe me një politikë të përbashkët të mbrojtjes". Berluskoni u shpreh se nëse Evropa bashkohet ushtarakisht, atëherë do të ishte "fuqi" e madhe botërore. Berluskoni, që ka shërbyer për tri mandate si kryeminister i Italisë, në muajin janar fillimisht e kishte përmendur mundësinë e garimit në zgjedhjet evropiane. Për gati pesë vjet, Berluskonit i ishte ndaluar që të garonte për ndonjë post publik, pasi ishte dënuar për mashtrim me taksa. Por, vitin e kaluar, një gjykatë vendosi që t'ia heqë këtë dënim.


Silvio Berluskoni

**SILVIO BERLUSKONI**

"Dua që Evropa të rikthehet në projektet e themeluesve të saj, që dëshironin një Evropë më të bashkuar, një Evropë me një politikë të jashtme të përbashkët dhe me një politikë të përbashkët të mbrojtjes", ka thënë Berluskoni.

## Me 98.1% të votave, për herë të parë një femër fiton zgjedhjet

# Zuzana Caputova zgjidhet Presidente e Sllovakisë

## Avokatja 45-vjeçare: Garova për vrasjen e gazetarit

Ditën e djeshme për herë të parë në Sllovaki ka fituar zgjedhjet presidenciale një femër. Zuzana Caputova, një avokate e mjedisit, fitoi zgjedhjet presidenciale, duke u bërë presidentja e parë e vendit me 5.4 milionë banorë. Pas numërimit të 98.1 për qind të votave, zonja Caputova doli fituese me 58.3 për qind, ndërsa kundër kandidati i saj, komisionari evropian, Maros Sefçoviç, mori 41.7 për qind të votave. Zonja Caputova, e cila mbron të drejtat e homoseksualëve dhe kundërshton ndalimin e abortit në Sllovaki, kishte fituar 40 për qind të votave në raundin e parë të zgjedhjeve, para dy javësh. Fitorja e zonjës Caputova shihet si një shenjë që zgjedhësit refuzojnë klasën tradicionale politike, pas vrasjes tronditëse vitin e kaluar të një gazetari hulumtues, që po hetonte korrupsionin në nivelin e lartë. Zgjedhjet presidenciale në Sllovaki janë mbajtur vetëm një vit pas vrasjes së gazetarit investigativ Jan Kuçiak, i cili hulumtonte lidhjet e politikanëve me krimin e organizuar. Gazetari është vrarë me armë zjarri në shkurt të vitit 2018. Presidentja e re thotë se pikërisht kjo vrasje ka qenë një prej motiveve kryesore pse ka vendosur t'i futet garës presidenciale. Posti i presidentit në Sllovaki është ceremonial, por presidentja emëron kryeministrin dhe mund t'u vërë veto emërimeve të prokurorëve dhe gjykatësve. Dyzetë e pesëvjeçarja do të marrë postin e presidentes më 15 qershor. Caputova falënderoi votuesit në sllovakisht, çekisht, hungarisht, madje edhe në gjuhën rome. Caputova fitoi famë si avokate kur për 14 vjet udhëhoqi çështjen kundër ngritjes së një vendgrumbullimi ilegal mbeturinash dhe doli fituese. 45 vjeç, e divorcuar dhe nënë e dy fëmijëve, ajo është anëtare e partisë Sllovakia Progresiste, që nuk ka asnjë mandat në parlament. Ndërkaq, kujtojmë se nga vrasja e gazetarit sllovak, një prokuror i profilit të lartë ka dhënë dorëheqjen në Sllovaki, pas dyshimeve se ai kishte kontakte me personat të dyshuar si të përfshirë në vrasjen e tij. Gazetari Jan Kuçiak u vra në shtëpi me të fejuarën në muajin shkurt 2018. Ai shkroi për korrupsionin politik dhe për mashtrimet e qeverisë. Vrasja e Kuçiak ka bërë që dy prokurorë të profilit të lartë të japin dorëheqjen, të gjendur nën presionin e masave që mbushën sheshet. Më parë, pikërisht për vrasjen e Kuçiak dha dorëheqjen edhe ish-kryeministri Robert Fico. Autoritetet sllovake liruan të shtatë italianët e ndaluar në lidhje me vrasjen e gazetarit. Lirimi u bë pasi një i paraburgosur u ankua për dhimbjen në gjoks. Të dyshuarit u arrestuan si pjesë e një hetimi për vrasjen e Jan Kuçiak, 27 vjeç dhe të dashurës së tij, të cilët u gjetën të vrarë në shtëpinë e tyre. Kuçiak ishte gati të botonte një artikull mbi dyshimet për lidhje korrupsioni politik të nivelit të lartë me mafien italiane "Ndrangheta" të Kalabrisë. Shtatë biznesmenë italianë të përmendur nga Kuçiak në raportin e tij janë Antonino Vadala, 42 vjeç; Sebastiano Vadala, 45 vjeç; Bruno Vadala, 40 vjeç; Diego Roda, 62 vjeç; Antonio Roda dhe Pietro C., 54 vjeç. Hetuesit thanë se vdekja e Kuçiak ka shumë mundësi të jetë e lidhur me raportin e tij. Mijëra veta morën pjesë në protesta dhe memoriale të antikorrupsionit, që u mbajtën në Sllovaki në reagim ndaj vrasjes së Kuçiakut. Organizatorët thanë se rreth 25,000 njerëz u mblodhën në Bratislavë, ndërsa mijëra të tjerë dolën në qytete të tjera në të gjithë Europën.


Presidentja e Sllovakisë, Zuzana Caputova

**PROFILI I ZUZANA CAPUTOVA**

Presidentja e re, e para femër në Sllovaki është 45 vjeç, e divorcuar dhe nënë e dy fëmijëve. Ajo është anëtare e partisë Sllovakia Progresiste, që nuk ka asnjë mandat në parlament. Caputova fitoi famë si avokate, kur për 14 vjet udhëhoqi çështjen kundër ngritjes së një vendgrumbullimi ilegal mbeturinash dhe doli fituese. Ajo mbron të drejtat e homoseksualëve dhe kundërshton ndalimin e abortit në Sllovaki.

## Zëvendëspresidenti afgan i shpëton një atentati, vdes truproja

Zëvendëspresidenti i Afganistanit, Abdul Rashid Dostum, ka shpëtuar pa lëndime nga një sulm i dyshuar i talebanëve, ku ka mbetur i vdekur njëri nga truprojat e tij. Një zëdhënës i policisë rajonale tha se autorët kishin sulmuar kolonën e zëvendëspresidentit Dostum më 30 mars, rrugës për në Mazar-e Sharif, një qytet në në veri të Afganistanit. Munir Ahmad Farhad, zëdhënës i guvernatorit provincial të Balkh tha se militantët talebanë e kishin sulmuar kolonën në dy pika, në qarkun Char Bolak dhe në Faiz Abad. Përmes një deklarate, ushtria tha se katër talebanë janë vrarë dhe shtatë të tjerë janë plagosur gjatë këtyre dy sulmeve. Përmes një postimi në "Twitter", zëdhënësi i talebanëve mori përgjegjësinë për sulmin dhe tha se katër truproja të Dustom janë vrarë.



**SHKURT**

### "Ora e Tokës", bota fiku dritat për një orë

Eshtuna shënoi përvjetorin e dymbëdhjetë të "Orës së Tokës", një eveniment që kremtohet në mbarë botën. Më 30 mars në orën 20:30 me orën lokale, njerëz nga e gjitha bota fikën për një orë dritat, duke iu bashkuar një momenti global solidariteti në ndihmë të mjedisit. "Ora e Tokës" pati pikënisjen e saj në vitin 2007 në Sidnej të Australisë. Atëherë dritat u fikën në 2.2 milionë shtëpi dhe biznese për një orë, me qëllimin për të pasur vëmendjen globale ndaj çështjeve alarmante të mjedisit. Që atëherë, kjo iniciativë u kthye në fenomenin më të madh të ndërgjegjësimit mbarëbotëror për çështjen e mjedisit dhe mori mbështetje të gjerë edhe nga Fondi Botëror për Natyrën.

### Alaska thyen rekord të nxehtësisë

Banorët e Alaskës, shteti më verior i SHBA-ve, po përballen prej disa javësh me rekorde të temperaturave, që kalojnë në disa vende më shumë se 15 gradë celsius. "Muajt shkurt dhe mars kanë qenë që të dy jashtëzakonisht të ngrohtë. Madje, shumë vende janë duke thyer rekordet e nxehtësisë për muajin mars", thotë Rick Thoman, specialist i Qendrës për Vlerësimin dhe Politikat e Klimës në Alaskë. Qytete si Wainwright, Nuiqsut, Kaktovi dhe Barrow, që ndodhen në veri të shtetit amerikan, në rrethin arktik, mund të arrijnë këtë fundjavë temperatura më të larta se 14-22 gradë celsius, shkruan ATSH. Në këtë rajon të Alaskës, temperaturat në këtë periudhë të vitit zakonisht qëndrojnë nën zero.

### Përgjaken zgjedhjet lokale në Turqi, 2 të vrarë nga përleshjet

Zgjedhjet lokale në Turqi, të parat që kur Rexhep Taip Erdogan u rizgjodh president me kompetenca të zgjeruara, u shoqëruan me tensione. Dy persona u vranë dhe 1 tjetër u plagos në një qendër votimi në provincën e Malatjasë në juglindje të Turqisë. Viktimat ishin mbështetës të një partie opozitare me profil islamik, të cilët thanë se personat që qëlluan ishin zyrtarë të partisë së presidentit Erdogan, që ushtronin presion ndaj votuesve. Teksa votoi në Stamboll, presidenti shprehu besimin te fitorja e thellë, por tha se rasti do të hetohet në mënyrë të pavarur nga organet e drejtësisë. Sondazhet parashikojë fitoren e Partisë për Drejtësi dhe Zhvillim të presidentit turk, por pritet një rënie e mbështetjes popullore. Kandidatët e opozitës së bashkuar në koalicionin "Aleanca Kombëtare" pritet të fitojnë Ankaranë dhe Stambollin, që konsiderohen si bastionet më të rëndësishme të Erdoganit.

Opinioni i Ditës

# 10 vjet Marrëveshje Stabilizim-Asocimi-MAS: Të ecësh drejt BE-së

Nga Geron Kamberi

*(vijon nga faqja 1)*



... zyrtarisht në fuqi Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit të BE me Shqipërinë. Negocimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit mes Shqipërisë e BE-së ofroi sfidën e parë të përballjes së kapaciteteve teknike e institucionale të vendit, në një proces negociatash, që zgjati 3 vjet 31.01.2003-01.06.2006 dhe që u pasua nga një periudhë 3-vjecare ratifikimi nga vendet e BE (2006-2009). Në thelbin e tij, sfondi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit pasqyronte qasjen që BE kishte përgatitur për rajonin pas shumë vitesh pritjeje. Përfundimi i luftërave në Ballkan, që shoqëruan procesin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë e detyruan Bashkimin Europian të merrte rolin "e fuqisë së butë e transformuese të rajonit", duke ofruar stabilizimin dhe më pas perspektivën e anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. Samiti i Zagrebit i 27 nëntorit 2000 futi një term të ri në fjalorin e larmishëm të euro-integrimit, siç do të përkufizohej Procesi i Stabilizim-Asocimit, procesi politik i bashkëpunimit të BE-së me vendet e Ballkanit dhe Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, me të cilën do të realizohej marrëveshja e re institucionale me vendet e rajonit si Serbia, Mali i Zi, Bosnja-Hercegovina, Maqedonia, Kroacia dhe Kosova deri në anëtarësimin e tyre të plotë në BE. Ndonëse nuk ishte pjesë e vendeve të ish-Jugosllavisë, Shqipëria nuk kishte arritur t'u bashkëngjitej valëve të tjera të zgjerimit drejt BE në Europën Qendrore e Lindore-EQL 2004, 2007 duke rënë viktimë e sindromës së "rastit të humbur" për shkak të një tranzicioni të brendshëm social-ekonomik, që stërzgjatej për shkak të konfliktit politik. Në këtë mënyrë, Procesi i Stabilizimi-Asocimit, që u pasua nga modeli i Marrëveshjeve të Stabilizim-Asocimit - MSA do të ishte për Shqipërinë jo vetëm nisja e një procesi jo të lehtë transformimi gradual në të gjitha fushat, por tashmë një pikë kthese drejt anëtarësimit të BE-së. Si një instrument i rëndësishëm politik dhe ekonomik, Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, MSA-ja, do të hidhte bazat e një partneriteti të qëndrueshëm me Bashkimin Europian, duke bërë një element të matshëm zbatimin e detyrimeve të saj nga ana e Shqipërisë përmes Progres- Raporteve të përvitshme të Komisionit Europian. Nëpërmjet 10 kapitujve, 135 Neneve, 7 Anekseve e 6 Protokolleve të MSA, që janë diskutuar në raundet politike e teknike të negociatave, Shqipërisë iu bënë të qarta nga ana e BE-së qëllimet e angazhimet e ndërsjella ku përfshiheshin bazat e dialogut politik, thellimi i bashkëpunimit rajonal, përfshirë vendosjen e një zone të tregtisë së lirë rajonale; perspektivën e vendosjes së një zone të tregtisë së lirë mes BE e Shqipërisë brenda 10 vitesh që nga hyrja në fuqi e marrëveshjes, angazhimin e Shqipërisë për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të acquis të BE; bazat e bashkëpunimit mes palëve në fusha si drejtësia, liria dhe siguria. Që prej vitit 2000 deri në 31 janar 2003 kur kryekomisioneri Prodi njoftoi zyrtarisht hapjen e negociatave mes Shqipërisë e BE-së për nënshkrimin e MSA, kalendari kohor i ngjan një maratone procesesh që do të ndjehej përgjatë gjithë kësaj periudhe. Në qershor 2001, Këshilli i Ministrave të Jashtëm të BE-së miraton raportin e Komisionit Evropian mbi progresin e bërë nga Shqipëria dhe i kërkon Komisionit përgatitjen e projekt-direktivës për negocimin e një Marrëveshjeje Stabilizim-Asocimi (MSA) me Shqipërinë. Por, që para hapjes së negociatave me BE-në për MSA nga pala shqiptare u pranua monitorimi i procesit të reformave, nëpërmjet një mekanizmi unik të quajtur Grupi i Përbashkët Konsultativ Shqipëri-BE. Një praktikë e tillë vazhdoi edhe pas hapjes së negociatave, duke shënuar një veçori për rastin e Shqipërisë. Takimet e Grupit Konsultativ të Përbashkët kanë trajtuar progresin e bërë në ecurinë e reformave sektoriale në të gjitha drejtimet si: procesin zgjedhor, Situatën politike, çështjet e drejtësisë dhe punëve të brendshme, çështjet e ekonomisë dhe financave. Pasi u krijua Grupi Konsultativ BE-Shqipëri në 2002, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE miratoi projekt-direktivën për negocimin e një MSA-je dhe vendosi hapjen e negociatave për nënshkrimin e një MSA-je me Shqipërinë. MSA-ja rikonfirmonte të ashtuquajturat kritere të Kopenhagenit dhe mbështetet mbi disa parime bazë, duke filluar nga respekti për parimet demokratike, të drejtat e njeriut, ligjin ndërkombëtar, shtetin ligjor si dhe respektin për parimet e ekonomisë së tregut (MSA, Neni 2). Gjithashtu, parime kryesore të marrëveshjes përbënin edhe përpjekjet për paqe e stabilitet në rajon, bashkë me marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë (Neni 3), si dhe bashkëpunim të thelluar rajonal në aspektin ekonomik, sidomos tregtisë së lirë (Neni 4). Sipas Artikullit 6, asocimi i vendit me BE-në duhet të realizohej përgjatë një periudhe tranzitore me një kohëzgjatje maksimale prej dhjetë vjetësh. Vendi i parë që e ratifikoi MSA-në BE-Shqipëri ishte Letonia (19 dhjetor 2006). Gjatë vitit 2007 vijuan ratifikimet nga plot 14 vende të tjera (Slloveni, Spanjë, Hungari, Suedi, Irlandë, Sllovaki, Lituani, Poloni, Luksemburg, Mbretëri e Bashkuar, Itali, Estoni, Holandë dhe Finlandë). Vendet e tjera anëtare (Danimarkë, Maltë, Austri, Republika Çeke, Qipro, Portugali, Belgjikë, Francë dhe Gjermani) e përmbyllën procesin e ratifikimit brenda vitit 2008. Me mbylljen e ratifikimit nga Greqia në janar 2009 dhe pas dorëzimit të pritshëm të instrumenteve të ratifikimit të Komisionin Europian përfundon edhe procesi i ratifikimit të MSA-së, i cili së bashku me nënshkrimin Protokolleve të Zgjerimit me dy vendet e reja anëtare (Rumania dhe Bullgaria), i hapi udhë hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje më 1 prill 2009. Por, nga nënshkrimi i MSA-së në 2006 deri në hyrjen e saj në fuqi në 1 prill 2009, një tjetër marrëveshje do të rregullonte marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe BE-së, që do të ishte "Marrëveshja e Ndërmjetme për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian". Marrëveshja e Ndërmjetme vendosi baza të qëndrueshme të reciprocitetit në lidhje me detyrimet dhe të drejtat në fushën e tregtisë mes Shqipërisë e BE, por duke favorizuar Shqipërinë për eksportet e saj drejt BE. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, Bashkimi Evropian liberalizoi pothuajse tërësisht të gjitha linjat tarifore me Shqipërinë menjëherë në dhjetor 2006, me përjashtim të disa produkteve bujqësore sensitive, të cilat vazhduan të jenë nën masa mbrojtëse. Ndërsa, liberalizimi tarifor nga pala shqiptare, në linjë me Marrëveshjen e Ndërmjetme, u përmbush në mënyrë të përshkallëzuar deri në vitin 2011, në mënyrë që t'i jepej kohë tregut shqiptar dhe operatorëve ekonomikë për të fuqizuar kapacitetin e tyre për të konkurruar. Kështu, sipas MSA-së, mallrat e prodhuara në Shqipëri mund të futen në tregun e BE-së pa paguar doganë dhe pa u kufizuar në sasi. Në këtë mënyrë, një tregtar, shqiptar apo i huaj, mund të fuste në tregun europian aq mallra të prodhuara në Shqipëri sa ka mundësi të shesë në tregun europian dhe nuk duhet të paguante doganë për to, me përjashtim të disa produkteve së disa lloje peshku e pijesh alkoolike. Duhet theksuar se, që mallrat shqiptare të mund të përfitojnë nga hapja e tregut europian duhet të respektojnë rregullat e origjinës - d.m.th. të vërtetohet se janë prodhuar ose përpunuar në Shqipëri mbi një masë të caktuar. Pra, me anë të MSA-së, Bashkimi Europian ka me Shqipërinë këtë marrëdhënie tregtare preferenciale vetëm për mallrat me origjinë shqiptare dhe jo edhe për ato që vijnë nga vende të treta. Ndërkohë, dimensioni i bashkëpunimit rajonal mori rëndësi të madhe brenda MSA. Fillimisht bashkëpunimi rajonal u zhvillua përmes marrëveshjeve dypalëshe të tregtisë së lirë (FTA), ku Shqipëria nënshkroi marrëveshjen e parë me Maqedoninë në vitin 2002, e pasuar nga marrëveshjet me Kosovën dhe Kroacinë në vitin 2003 dhe një vit më vonë nga marrëveshjet me Serbinë dhe Malin e Zi, si dhe me Bosnjën dhe Hercegovinën. Edhe pse të rëndësishme, këto marrëveshje dypalëshe dhe Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Liberalizimin dhe Lehtësimin e Tregtisë që u parapriu nuk ishin të mjaftueshme për të krijuar një zonë të lirë tregtie për rajonin. Për këtë arsye, BE-ja vendosi t'i përfshinte vendet e Ballkanit Perëndimor në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore (CEFTA). Si rrjedhojë, Shqipëria së bashku me vendet e tjera të rajonit, përfshirë edhe Moldavinë, u bënë pjesë e CEFTA-s në vitin 2006. Përpos marrëveshjeve të mësipërme, Shqipëria nënshkroi në 2009-ën një Marrëveshje të Tregtisë së Lirë edhe me vendet e EFTA-s, duke e zgjeruar kështu zonën e tregtisë së lirë në të cilën vendi bënte pjesë. Aktualisht, si pasojë e zbatimit 10-vjeçar të MSA, volumi tregtar midis Shqipërisë dhe BE-së është më tepër se dyfishuar, krahasuar me momentin e hyrjes në fuqi të marrëveshjes tregtare në dhjetor 2006. Periudha dhjetëvjeçare e zbatimit të MSA parashtroi para biznesit shqiptar jo vetëm mundësitë për eksporte më të mëdha drejt BE, por edhe standardizimin e cilësisë së produkteve të prodhuara, në përputhje me direktivat e rregulloret e BE, që ishin pjesë e acquis. Gjatë periudhës së zbatimit të MSA 2009-2019 ka qenë objekt monitorimi nga struktura të shoqërisë civile të mbështetur ➔

Dje në Deutsche Welle

# Zgjedhje në Turqi, vjelje votash me dënimin me vdekje?

Nga Hilal Köylü

(vijon nga faqja 1)

... deklaron se do ta rivendosë atë. Taktikë zgjedhore apo qëllim serioz? Për presidentin turk, Recep Tayyip Erdogan kjo është temë presidenciale. Kreu i shtetit dhe i partisë qeverisëse, AKP e përsërit pa asnjë ngurrim në daljet e tij në fushatën zgjedhore, përkrahësit e tij bërtasin në mitingje "ne kërkojmë dënimin me vdekje". "Heqja e dënimit me vdekje është një gabim i madh!", thekson Devlet Bahçeli, kreu i partisë ultranacionaliste, MHP. "Na lini ta fusim sërish dënimin me vdekje në parlament", kërkon MHP, që për zgjedhjet lokale ka krijuar një aleancë me partinë AKP. Në Asamblenë e madhe Kombëtare, AKP dhe MHP kanë shumicën. Para 15 vitesh Turqia e hoqi dënimin me vdekje. De facto ai nuk ishte zbatuar që prej 35 vjetësh. Por, që nga ardhja e Erdoganit në pushtet dhe partia MHP është partnere e ngushtë e tij, kjo temë rikthehet herë pas here, sidomos para zgjedhjeve parlamentare e lokale e aq më shumë pas përpjekjes për puç në vitin 2016. Shtrohet pyetja: Vërtet ka përpjekje të aleancës AKP-MHP për të futur dënimin me vdekje, apo kjo është më shumë një strategji e presidentit për të mbledhur vota tek elektorati konservator? Përfaqësues të AKP-së në bisedë me "Deutsche Welle"-n theksojnë se fokusi qëndron tek zgjedhjet lokale dhe nuk shpenzohet energji për të futur dënimin me vdekje. Tema të tjera janë më të rëndësishme aktualisht, si gjendja e vështirë ekonomike.

**OPOZITA: ERDOGANI BËN BLOF**

"Gjithmonë kur AKP i ka punët keq, fiksohet pas një teme. Me këtë, ajo e çorienton popullin. Por, e gjitha është retorikë e fushatës zgjedhore. Ne nuk e marrim seriozisht, këtë i shtohet që nga ana juridike është e pamundur", shprehet Murat Emir, anëtar i partisë më të madhe opozitare, CHP lidhur me retorikën e rifutjes së dënimit me vdekje. Sipas tij, Erdogan ka vetëm një synim - të mbledhë votat e elektoratit nacionalist. Edhe juristja e partisë opozitare prokurde, HDP, Meral Dan? Be?ta? ndan të njëjtin qëndrim për sulmet verbale të presidentit. "Ai ngroh sërish kafenë e ftohtë e kërkon të manipulojë krenarinë kombëtare të njerëzve, por njerëzit e kuptojnë këtë". Edhe deputeti Lütfü Türkkan, i partisë po nacionaliste ?Y?-shikon në deklaratat e presidentit turk, fushatë të pastër zgjedhore dhe parashikon që presidenti pas zgjedhjeve nuk do ta zërë më në gojë këtë fjalë të tmerrshme. Partitë ?Y? dhe CHP kanë krijuar aleancë për zgjedhjet lokale të 31 marsit. "Nëse Erdogan do të kishte parë një reagim pozitiv tek zgjedhjet, ai do ta kishte futur prej kohësh dënimin me vdekje. Çdo temë dërgohet në parlament, pra është e qartë, që çdo urdhër i Erdoganit shihet në këtë sallë si ligj dhe për më shumë zbatohet".




**"E PAZBATUESHME NGA ANA KUSHTETUESE"**

Po nga ana juridike si shihet dënimi me vdekje? Juristi i së drejtës kushtetuese dhe anëtar i CHP-së, Ibrahim Kabolu, e sheh të pamundur rifutjen e dënimit me vdekje. "Madje edhe në luftë, në rast mobilizimi të forcave të armatosura, në vendosjen e ligjit të luftës apo gjendjes së jashtëzakonshme krimet dhe veprat penale nuk mund të ndiqen me prapaveprim", thotë Kabolu për 'DW'. Ai kujton qëllimin e Erdoganit, ekzekutimin e organizatorëve të përpjekjes për puç ushtarak. Por, këtë ai mund ta bëjë vetëm me ndryshimin e Kushtetutës dhe kështu me efekt prapaveprues të dënojë edhe këto vepra me dënim me vdekje. Kabo?lu pohon se aktualisht nuk po punohet nga ana politike për ndryshimin e Kushtetutës. Por, ai përmend edhe një temë tjetër: "Turqia ka nënshkruar Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Një rivendosje e dënimit me vdekje do të ishte shkelje e konventës. Me këtë Turqia do të hidhte në erë të gjitha urat lidhëse me Europën. E kjo është sipas mendimit tim, e pamundur".

---

nga OSFA, për të vlerësuar nivelin e zbatimit dhe kostot e përfitimet e kësaj marrëveshjeje, veçanërisht në fushën e tregtisë, investimeve të huaja dhe përafrimit të legjislacionit. Aktualisht Qendra Shqiptare për Konkurrueshmërinë e Tregtinë Ndërkombëtare - ACIT, me mbështetjen e fondacionit "Shoqëria e Hapur për Shqipërinë" po realizon një monitorim të periudhës 10-vjeçare 1.04.209-1.04.2019, në vijim të proceseve të mëparshme që janë realizuar nga ekspertë të shoqërisë civile. Thelbi i zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit - MSA për Shqipërinë gjatë këtyre 10 viteve ka qenë përafrimi i legjislacionit kombëtar me atë të BE, liberalizimi i tregtisë me BE përmes uljes e heqjes së tarifave doganore dhe krijimi i strukturave të reja institucionale dhe atyre ekzistuese për të përballuar detyrimet e përmbushjeve, ku mund të përmenden institucione të tilla si Autoriteti Kombëtar i Ushqimit-AKU, Autoriteti Kombëtar i Konkurrencës, Qendra e Metrologjisë, Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, Inspektorati i Mbikëqyrjes së Tregut etj.. Pjesa dërrmuese e MSA-së bazohet në acquis-n e BE-së, përkatësisht tërësinë e normave juridike të zbatueshme brenda territorit të saj dhe nga të gjitha shtetet anëtare si subjekte juridike, duke mbuluar të gjitha fushat e politikave sektoriale. Prandaj, Shqipëria, si shtet që synon anëtarësimin në BE, gjatë procesit të zbatimit të MSA, që është ndërtuar në bazë të parimit të kushtëzimit, ndërmori angazhimin përmes Planit Kombëtar të Zbatimit të MSA 2007-2012, që përditësohej çdo vit për t'u pasuar nga Planet Kombëtare të Integrimit 2014-2020 realizimin e një sërë reformash institucionale e ligjore, që përfshinin 35 kapitujt e acqui communitaire. Ne këtë mënyrë, ekonomia e Shqipërisë krijon një lidhje më të ngushtë e më të harmonizuar me rregullat e tregut të BE, duke u bërë gati të jetë pjesë e 4 lirive që qëndrojnë në themel të BE, liria e lëvizjes së mallrave, njerëzve, shërbimeve e kapitalit. Gjatë 10-vjeçarit të zbatimit të MSA, Shqipëria ka përjetuar eksperiencën Dialogut Politik me BE-në përmes Këshillit të Stabilizim-Asocimit, Komitetit të Stabilizim dhe Komitetit Parlamentar BE- Shqipëri, struktura që u ngritën në bazë të parashikimeve të Kapitulli X i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit. Ndërsa, Këshilli i Stabilizim-Asocimit mbikëqyr zbatimin e MSA-së dhe shqyrton çdo çështje madhore, që del në kuadër të saj me pjesëmarrjen e anëtarëve të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Komisionit nga njëra anë dhe anëtarë të qeverisë shqiptare nga ana tjetër (nivel ministror), Komiteti i Stabilizim-Asocimit u krijua me qëllim që të ndihmojë Këshillin e Stabilizim-Asocimit në kryerjen e detyrave të tij. Procesi i Zagrebit në vitin 2000, që u pasua me MSA, u riemërtua si Procesi i Selanikut (2003) dhe tashmë kemi Procesin e Berlinit (2014), por në thelb dekada e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit është pararendëse e procesit të ardhshëm të negociatave për anëtarësim mes Shqipërisë e BE-së. Më 28 prill 2019 mbushen 10 vjet kur Shqipëria paraqiti zyrtarisht kërkesën për t'u pranuar si anëtare me të drejta të plota në BE dhe tashmë shpreson që sindromi i kohës apo rastit të humbur t'i përkasë historisë pa përsëritur vetveten.

---

## HOROSKOPI

**DASHI**

Të lindurit e kësaj shenje duhet të shmangin vendet publike shumë të populluara. Ka gjasa që duke qenë mes të huajve, mund të humbisni sendet tuaja, ose të bëheni viktimë e një mashtrimi.

**DEMI**

Mund të mendoni të ndryshoni fatin profesional. Kjo këshillë vlen mbi të gjitha nëse nuk jeni të kënaqur me të ardhurat, karrierën apo marrëdhëniet profesionale. Shmangni personat që tentojnë të ndërhyjnë në botën tuaj të brendshme.

**BINJAKET**

Binjakët mund të bëjnë një udhëtim të këndshëm sot me familjarët. Megjithatë, kjo mund t'i ndërlikojë pak planet e tjera. Shihni anën e mirë të asaj çfarë po ndodh rreth jush. Ka gjasa që t'ju ndodhë një koincidencë misterioze, që do të hedhë dritë mbi një çështje të rëndësishme.

**GAFORJA**

Një person interesant ose një projekt i pazakontë mund t'ju mahnitë gjatë kësaj dite. Ka mundësi që personi në fjalë të vendosë për të ardhmen tuaj të afërt, përndryshe kjo ditë do të jetë e zakontë. Kushtojini rëndësi mirëqenies.

**LUANI**

Luanët mund të jenë paksa të dëshpëruar sot. Arsye për këtë do të jenë disa probleme të vogla në punë, mungesa e vëmendjes nga seksi i kundërt ose mungesa e vetëbesimit. Bëni gjithçka që mundeni për ta kaluar këtë situatë.

**VIRGJERESHA**

Disa Virgjëresha mund të bëhen viktimë e komenteve apo lojërave të dikujt. Humori nuk do të jetë gjithnjë i përshtatshëm për ju. Përpiquni t'i shmangni personat, të cilët iu bëjnë të ndiheni keq. Pjesa tjetër e ditës do të sjellë rezultate produktive.

**PESHORJA**

Mund të jeni një hap më afër ëndrrës suaj. Ka gjasa të merrni përgjigje pozitive ndaj një pyetjeje nga e cila varet e ardhmja juaj. Rekomandohet t'i caktoni disa qëllime vetes dhe të përpiqeni maksimalisht për t'i realizuar ato.

**AKREPI**

Kjo e hënë mund të jetë befasuese për ju. Mund të merrni një lajm lidhur me të ardhmen e martesës suaj. Do të kaloni një mbrëmje të qetë, duke iu përkushtuar plotësisht vetes në përpjekje për të gjetur rehati psikologjike.

**SHIGJETARI**

Disa Shigjetarë rrezikojnë të humbasin një gjest të veçantë nga sjellja e dikujt. Kjo do të bëjë që ju mos të kuptoni ndjenjat e shfaqura nga kolegu/kolegia juaj apo miku/mikja juaj. Çiftet e martuara rekomandohen të sillen më butë me gjysmën e tyre të zemrës.

**BRICJAPI**

Ekziston mundësia që personi me të cilin keni kaluar fëmijërinë apo që keni pasur një marrëdhënie dashurie pasiononte të rikthehet. Pjesa tjetër e ditës së sotme do të jetë ekzaktësisht siç e kishit planifikuar. Ka gjasa të realizoni një projekt të nisur prej ditësh.

**UJORI**

Nëse nuk do të mund të kontrolloni emocionet, mund të përfshiheni në një situatë të vështirë. Përpiquni ta parandaloni këtë duke shmangur konfliktet apo thashethemet. Sa i përket punës, do të arrini rezultate të mira.

**PESHQIT**

Kjo ditë do të kalojë pa ndonjë situatë të veçantë. Merrni parasysh këshillat e personave të afërt, pasi do t'ju vijnë mjaft në ndihmë. Tregohuni të qetë dhe të duruar në marrëdhënien tuaj të dashurisë dhe shmangni bisedat që mund t'ju çojnë drejt një konflikti.

### Qëndrimi skandaloz i institucionit të futbollit

## Më herët ka nxituar të reagojë, sot FSHF vijon të heshtë për dhunën

Federata Shqiptare e Futbollit nuk ka humbur rast që të nxitojë të akuzojë dhe ndëshkojë dhunuesit sa herë që e ka parë të arsyeshme, sikundër ka ndëshkuar me dënime modeste apo shpesh edhe falur dhunues të gjyqtarëve dhe lojtarëve, duke shkelur vetë parimet që institucioni i futbollit kërkon të transmetojë. Tirana ka akuzuar në dy raste radhazi për dhunë ndaj saj, por FSHF-ja as nuk e ka vënë ujin në zjarr. Ndryshe ka ndodhur më herët, kur nuk ka hezituar të reagojë dhe dënojë Partizanin për dhunën e tifozëve ndaj fotografit të Flamurtarit, apo të shkrijë Kamzën për dhunën ndaj kryesorit Hamiti. Madje, shkoi deri atje sa të mbështesë bojkotin e gjyqtarëve (për të mos thënë që e ka organizuar vetë FSHF-ja) vetëm e vetëm për të organizuar një tryezë me qeverinë, ku u fol pak për dhunën dhe shumë për përfitimet ekonomike. Si për ta rënduar pozicionin e FSHF-së në këtë situatë, është edhe falja e Albano Isajit, lojtari i Shkumbinit që u dënua me 3 vjet për dhunën ndaj gjyqtarit Klajdi Kola, por që pas 7 muajsh merr faljen me kusht nga ana e Disiplinës. Ndaj, Tirana bën shumë mirë që troket në FIFA dhe UEFA, duke shpresuar që të gjejë drejtësinë për vete dhe të shkundë dy institucionet për qenë më të vëmendshme në futbollin e brishtë shqiptar, sidomos UEFA, që tanimë ka në KE-në e saj edhe presidentin e FSHF-së, Armand Dukën!

Grushtet ndaj anglezit Ngoo, por edhe situatat me gjykimin kanë acaruar 24 herë kampionët

# Tirana s'duron më dhunimin: Do të ankohemi në FIFA e UEFA

## *Bardheblutë akuzojnë FSHF-në: Nuk ka reaguar*



Jeton Selimi

Incidenti i djeshëm në përfundim të sfidës mes Tiranës dhe Laçit ishte një tjetër akt i turpshëm i dhunës në kampionatin tonë. Lojtari me ngjyrë i Tiranës, Majkëll Ngoo, u godit dhunshëm nga pjesëtarë të stafit të skuadrës kurbinase. Anglezi pati një fërkim me fjalë me presidentin e Laçit, Pashk Laskën dhe kërkuan të godisnin njëri-tjetrin, por u frenuan nga lojtarët e Tiranës dhe ata laçianë. Më pas ishte Ngoo, ai që ra pre e dhunës së disa anëtarëve të ekipit kurbinas. Kjo ka acaruar pa fund skuadrën e Tiranës, që ka njoftuar bashkëpunimin me policinë e Tiranës lidhur me çështjen e dhunës dhe me FIFA-n dhe UEFA-n në lidhje me gjykimin, pasi nga ana e Federatës Shqiptare të Futbollit nuk ka marrë përgjigje lidhur me incidentet e ndodhura në dy javët e fundit.



"Klubi i Futbollit 'Tirana' dënon ashpër ngjarjet e ndodhura dje në stadiumin 'Selman Stërmasi'. Lojtarët e Tiranës u provokuan dhe u dhunuan. Klubi i ka vënë në dispozicion të policisë së Tiranës pamjet filmike për gjithçka ka ndodhur në përfundim të ndeshjes Tirana-Laçi dhe pret zbardhjen e ngjarjes si dhe pasojat ligjore. Denoncimet publike në këtë vend, thuajse gjithmonë kanë rënë në vesh të shurdhët për të mos sjellë ndryshim. Për këtë dhe të tjera arsye zgjedhim të mos flasim gjatë, por të veprojmë. Dy javë më parë, gjyqtari Olsi Sokoli vodhi turpshëm skuadrën në fushë ndaj Kastriotit dhe klubi ka hapur një çështje ndaj tij në FIFA, në sektorin e luftës kundër racizmit, në mungesë të një përgjigje nga Federata Shqiptare e Futbollit. Dje skuadra u vodh në fushë, në një ndeshje që mund të luhej deri në të gdhirë sipas kryesorit Kridens Meta dhe më pas u provokua dhe u godit turpshëm. Pamjet filmike janë depozituar me Policinë e Tiranës. Ngjarjet e dy javëve të fundit do të relatohen gjithashtu në UEFA dhe FIFA", shkruan klubi bardheblu në komunikatën e tij. Sfida ndaj Laçit kulmoi me goditjen e Majkëll Ngoo, por tensioni ishte mjaft prezent edhe në fushën e lojës, pasi gjyqtari anësor Bregasi u godit me një shishe në kokë nga tribuna dhe u rrëzua në tokë për pak çaste, ndërsa në përfundim të sfidës, i gjithë stafi bardheblu rendi të kërkojë llogari te kryesori Meta, duke u futur në fushën e lojës, raste që pa dyshim do të shqyrtohet nga Disiplina.

### PREMIER LIGË



## Fitore in-extremis, Liverpuli merr sërish vendin e parë

Liverpuli ka marrë një fitore dramatike në fundin e ndeshjes me Totenhemin. Skuadra e Jurgen Klop ka fituar 2-1 dhe ka marrë sërish kryesimin e Premier Ligës. Ishte Firminjo, ai që kaloi në avantazh Liverpulin në minutën e 16-të me një gjuajtje me kokë brenda zonës. Në pjesën e dytë Lukas barazon në 1-1, pas një asisti të Eriksen. Aty ku u duk se çdo gjë po shkonte drejt një barazimi për skuadrën e Klop, Alderveireld ka shënuar në portën e vet duke u dhënë trepikëshin kundërshtarëve. Kështu, Liverpuli është në vendin e parë me 79 pikë, dy më shumë se Siti, që ka një ndeshje më pak. Tashmë mbeten edhe shtatë javë nga fundi i kampionatit dhe gara për titull është më e nxehtë se kurrë. Çelsi ka mposhtur në limite ditën e djeshme ekipin e Kardifit. Blutë e Londrës nuk e patën aspak të lehtë në transfertë, teksa ia dolën me përmbysje të fitonin me rezultatin 1-2. Pas këtij triumfi, Çelsi renditet në vendin e 6-të të klasifikimit, ndërsa është 1 pikë larg Mançester Junajtid të vendit të 4-ët.

### Reagon mbrojtësi i Tiranës

## Imami: Dikush nuk na do, por ne jemi klubi më i madh

Tirana pësoi një gol në minutën e 98 të takimit ndaj Laçit, duke marrë vetëm një pikë nga ai takim që ishte thuajse i fituar nga bardheblutë. Vendimet e gjyqtarit duket se kanë lënë të prekur drejtuesit e Tiranës, të cilët në përfundim të ndeshjes ishin jo pak të irrituar. Mbrojtësi Eni Imami, nëpërmjet një postimi në rrjetin social "Instagram" ka shfryrë kundrejt asaj çka ndodhi në fushë dhe pas saj, duke shtuar se dikush nuk e do ekipin e Tiranës. Sakaq, Imami nuk harron të kujtojë se Tirana është klubi më i madh në histori. "Më vjen keq për çfarë ndodhi dje, sepse ishte detyrim fitorja jo për pozicionin që kemi, e as për veten tonë, por për nder të një njeriu që ka bërë historinë për



Tironën. Ishte minimumi që mund të bënim. E kërkuam, ishim dominues, por është shumë e vështirë, ndoshta dikush nuk na do, dikush s'na respekton mundin dhe djersën, dikush s'e do këtë skuadër. Është shumë e thjeshtë, na lini të bëjmë punën tonë, nuk duam as ndihmë, as dashakeqësi. I dalim për zot vet vetes sonë! Jemi klubi më i madh në historinë e Shqipërisë, këtë mos e harroni kurrë!", shkruante Imami.

### Napoli shpreson ta rikuperojë shpejt

## Hysaj dëmtohet në momentin e tij më të mirë

Afron momenti vendimtar i sezonit për Napolin dhe për Elseid Hysajn, por për fat të keq, kapiteni i përfaqësueses shqiptare është detyruar të ndalet sot nga një dëmtim, që e komplikon pak situatën e tij në një periudhë kur po flitej për rinovim apo për transferim. Hysaj ishte titullar dje në ndeshjen ndaj Romës në krahun e djathtë të mbrojtjes dhe po zhvillonte një paraqitje shumë pozitive për skuadrën e tij. Por, në minutën e 65-të të takimit, ai bëri shenjë nga stoli se nuk mund të vazhdonte më. Menjëherë Ançeloti vendosi për një zëvendësim, duke larguar shqiptarin nga fusha e lojës, ndërsa pritet që ai të zhvillojë disa kontrolle më të hollësishme mjekësore gjatë ditëve me vazhdim



për të kuptuar situatën dhe shkallën e këtij shqetësimi muskulor. Te Napoli shpresojnë që Hysaj të mos mungojë gjatë, pasi përpara kanë një sfidë shumë të rëndësishme për klubin, çerekfinalet e Ligës së Evropës përballë Arsenalit, ku trajnerin Ançeloti e kishte parashikuar si titullar futbollistin, duke qenë i bindur se me të në fushë, skuadra italiane do të kishte më shumë siguri në prapavijë.

# Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Emri i Monet.
8. Një top në rrjetë.
11. Carl Edward, që shkroi Contact.
12. Qe bukuroshi që u hidhte ferë perëndive.
15. Qe era hyjnore e japonezëve.
16. Një pjesë e lartësive.
18. Muzikanti që... nuk përsëriste.
20. Lumë në Rusi.
21. Është i lartë ai i kampionit.
22. Kalifi që themeloi Kairon.
24. Kështu e quajti Krishti shën Pjetrin.
25. Janë në guvë.
26. Ilioni portier.
27. Markë makine.
28. Ashtu si duhet të përgjigjet fituesi.
29. Inicialet e Mann.
30. Një parabolë e tenistit.
31. Fillojne tatepjeten.
32. Ente Autonome.
33. Jean, që solli duhanin në Europë.
34. Mund të jetë dëshmor.
36. Pak stabilitet.
37. Arturo i Brecht.
39. Një pjesë e onkologjisë.
40. Mbyllin një shtëpi.
41. Të parat në stafetë.
42. Qe profet i vogël.
45. Me break në tenis.
46. Mbyllin një sirtar.
47.Qe perëndesha që lindi Arionin.

VERETIKAL
1. Inicialet e Santana-s, kitarist.
2. Nota e diapazonit.
3. Është frika nga shehet e hapura.
4. Diftong në duar.
5. Duhen në ekstreme.
6. Qe libri erotik i Mallanaga Yatsyay-ana-s.
7. Lauda ish-pilot i Formula 1.
8. Janë lotët që gjithkush i derdh me kënaqësi.
9. Një poemë.
10. Fund tuneli.
12. Një eleganat si Aramis.
13. Qe kryeqyteti i Asirisë.
14. Qe toreador i famshëm.
15. Urdhëroi sakrifikimin e Ifigjenias.
16. Është pushteti i... bashkisë.
17. Qe lumi i Karontit.
18. Inicialet e Klee piktor.
19. Ishte gjuha e Jezu Krishtit.
23. U shndërrua në dre nga Afërdita.
28. Rex i Nero Wolfe.
35. Nino, kompozitor i njohur.
36. Një... story e John Le Carré.
38. Shkroi Tregime të jshtëzakonshme.
41. Kufizojnë një sektor.
42. Inicialet e Einstein.
43. Inicialet e Matthieu, këngëtare.
44. Kufizojnë sportet.

# Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Lindi Isakun.
3. Në krye te bashkisë.
5. Në djep kur nuk... je.
7. Nota e diapzonit.
9. Emri i parë i Erasmit të Rotterdamit.
12. Mbyllin akte.
14. Filozofi i famshëm me historine e gomarit.
15. Diku në qendër.
16. Rrallë është përgjysmë.
17. Bëri edhe Madame Butterfly.
18. Norman, psikopati te Psycho.
19. Të parat në sjellje.
20. Vret me një re.
21. Gjarpri që u vra nga Apolloni.
24. Lindi Perseun.
26. Besniku mesfushor
27. Ai i vajtimit është në Jerusalem.
29. Carol, aktore.
30. Në krye të subjekteve.
31. Rrëmbeu Helenën.
33. Fundi i një samurai.
35. Ishin hipokritë për Krishtin.
37. Ngrin... nga frika.
39. Përdorej kundër malaries.
40. Perëndia që u zu në gjumë nga Menelau dhe Aris-teu.
44. Tund në ekstreme.
45. Piaf e Milord.
46. Në hyrje të sallës.

VERTIKAL
1. Ishte sundimtari i provincave perseisha.
2. Inicialet e Duvall
3. Qytei i njembinjëdritarve.
4. Ishin armiqtëe babilonasve.
5. Shkroi Jacques le fataliste
6. Është edhe tendencë.
7. Joan i interpretuar nga Celentano.
8. Jetojnë në vetmi.
9. U soll në Europë në Jean Nicot.
10. Ai i Aida-s është Radames.
11. Një ishte edhe Decebali.
13. Inicialet e Rohmer regjisor.
18. Titulli i Bruce Springsteen.
20. Hidhet një me... kërcim.
22. U shkrua nga Camus.
23. Fillojnë takimin.
25. Fillojnë natën.
27. Pierce teniste.
28. Grisur pa gur.
31. Fillojnë panikun.
32. Shijuar pa shuar.
34. Fleming, që krijoi James Bond.
35. Kështu merr ai që... mbaron.
36. Mbajtësja e topit në golf.
37. Ekstreme për gotik.
38. Carson i fumnetti-t.
40. Një padi kur s'është ai.
41. Bëhen arianë me një anë.
42. Harris që krijoi Hannibal Lecter (inic).
43. Bëhet nuse me ne.



# Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

# SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3 | | | | | 8 | |
| | | 5 | 8 | 2 | | | 9 | 4 |
| | | | | | | | | |
| | | | 1 | 4 | | | 3 | |
| 1 | 6 | | | | 9 | | | |
| | | | | | | | 6 | |
| | | 6 | | | 5 | | | 7 |
| | 2 | | | | | | | 8 |
| | 8 | | 3 | | | 5 | 4 | |

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 3 | 9 | 6 | 8 | 1 | 5 | 4 | 7 |
| 6 | 4 | 8 | 7 | 9 | 5 | 3 | 2 | 1 |
| 1 | 5 | 7 | 2 | 4 | 3 | 8 | 9 | 6 |
| 3 | 8 | 1 | 9 | 5 | 6 | 4 | 7 | 2 |
| 7 | 9 | 6 | 8 | 2 | 4 | 1 | 3 | 5 |
| 5 | 2 | 4 | 3 | 1 | 7 | 6 | 8 | 9 |
| 4 | 7 | 3 | 1 | 6 | 2 | 9 | 5 | 8 |
| 9 | 1 | 2 | 5 | 3 | 8 | 7 | 6 | 4 |
| 8 | 6 | 5 | 4 | 7 | 9 | 2 | 1 | 3 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

# Argëtim filozofik

- Nëse bashkëshortët nuk do të jetonin së bashku, martesat e mira do të ishin më të shumta.

- Mirësia e një martese provohet me këtë, që ajo lejon një herë një "përjashtim".

- Kur lidhet një martesë duhet bërë kjo pyetje: a beson ti se mund të bashkëbisedosh mirë me këtë grua deri në pleqëri?

- Gjithë sa mbetet nga martesa është kalimtare, por koha më e madhe e jetës së përbashkët i përket bashkëbisedimit.

- Pak njerëz kanë në natyrë këtë: të nderojnë pa zili mikun e tyre të lumtur.

# KRIPTOSKEME



# KRIPTOSKEME

*Përgjigja e numrit të djeshëm*

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | Z | O | V | | E | T | N | A | | | B | A |
| Z | A | G | A | R | | R | A | | M | B | A | S |
| I | C | | K | A | L | I | | N | I | O | B | I |
| L | | C | A | S | U | S | B | E | L | L | I | |
| | T | E | N | T | A | T | I | V | A | T | | V |
| M | A | R | T | I | N | A | | E | N | | K | E |
| E | T | E | | S | E | N | | R | O | M | A | N |
| T | I | M | E | | T | I | P | I | | A | F | E |
| A | M | O | R | F | | | R | A | | T | A | R |
| L | O | N | | Z | E | T | A | | F | A | Z | A |
| E | R | I | C | | C | E | | V | O | N | E | |
| T | E | A | M | | A | L | B | A | N | E | T | |

# PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALEKRYQI (1)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| B | A | O | B | A | B | | P | E | D | A | N | A | T |
| R | | P | E | R | I | P | A | T | E | T | I | K | E |
| A | P | E | L | | R | I | V | | B | | N | A | R |
| V | E | L | | P | I | R | A | M | I | D | A | | M |
| A | R | | K | O | L | O | R | I | T | I | | L | E |
| | P | R | O | T | A | G | O | N | I | S | T | E | T |
| K | A | N | T | A | T | A | T | | | K | A | T | E |
| A | R | I | E | L | | | T | A | | U | R | | T |
| S | A | | L | A | | T | I | | K | | T | S | |
| P | | A | E | | S | I | | P | I | R | A | T | I |
| I | R | R | | M | I | | B | A | N | O | R | E | T |
| K | R | A | T | E | R | E | T | | G | J | I | R | I |

FJALEKRYQI (2)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| S | E | V | E | N | U | P | | S | T | E | F | F | I |
| A | M | I | N | | K | A | P | I | T | A | L | I | |
| R | I | T | E | T | | R | E | L | | | | A | M |
| A | L | E | T | | F | I | L | O | K | T | E | T | I |
| H | E | | | K | A | M | I | K | A | Z | E | | K |
| | | P | R | O | T | O | K | O | L | L | A | R | E |
| K | A | T | A | M | A | R | A | N | I | | | O | T |
| I | R | | C | O | L | I | N | | | R | O | M | Y |
| T | E | M | A | | E | | I | | B | O | R | I | S |
| A | N | I | T | A | | A | | M | I | L | A | N | O |
| R | A | N | | V | I | T | | M | J | E | R | A | N |
| E | T | I | L | E | N | | F | R | A | T | I | | |

# Thënie të mençura

- Është shumë më e vështirë të gjykosh veten sesa të gjykosh të tjerët. Nëse arrin ta gjykosh veten siç duhet, atëherë do të jesh vërtet një njeri i mençur.
- Pas një grindjeje apo një mosmarveshjeje vetjake mes një gruaje dhe një burri, nëra pale zakonisht vuan nga ideja që ka lënduar tjetrin, ndërsa tjetra vuan sidomos nga ideja se nuk e ka lënduar aq sa duhet tjetrin.
- Pas kufirit të urisë, të pasur dhe të varfër janë të njëjtë.
- Martesa është një institucion i domosdoshëm për moshën e të njëzetave, dhe i dobishëm për të tridhjetat, por jo i nevojshëm: ndërsa, për moshën më të vonë, shpesh është e dëmshme dhe përbën një kthim prapa për anën shpirtërore të burrit.


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
MARKETING: 0688087323
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al